


**RAPORTI VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR  
IMPIANTIN E THËRRMIT DHE SEPERIMIT TË  
GURIT GËLQËROR, NGA KOMPANIA “StoneX Holding”  
SH.P.K., BLLACË, KOMUNA E SUHAREKËS**



**INVESTITORI**  
**“StoneX Holding” SH.P.K.**  
**Bllacë, Suharekë**

**Maj - 2026**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR IMPIANTIN E THËRRMIMIT DHE SEPERIMIT TË GURIT GËLQEROR, NGA KOMPANIA “StoneX Holding” SH.P.K., BLLACË, KOMUNA E SUHAREKËS**

**Ngastrat me nr. P-72116003-04427-0, P-72116003-04428-0, P-72116003-04429-0, P-72116003-04430-0, Zona kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës**

| INVESTITORI  |                                    |
|--------------|------------------------------------|
| Aplikuesi    | Genc Bajraktari                    |
| Iinvestitori | “StoneX Holding” SH.P.K.           |
| Adresa:      | Brigada 123, pn Suharekë           |
| Lokacioni:   | Bllacë, Komuna e Suharekës         |
| Tel:         | +383 49 460 512<br>+383 49 761 765 |
| Email:       | Info@stonexholding.eu              |

Investitori:

**“StoneX Holding” SH.P.K.**

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

**Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari**

---

**Nënshkrimi dhe Vula**

---

**Nënshkrimi**

**Blerinabajraktari1@gmail.com**

**+383 49 588 634**

**Maj - 2026**

## **PËRMBAJTJA:**

|       |                                                                                                                                       |    |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.    | HYRJE.....                                                                                                                            | 8  |
| 2.    | PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....                                                                                              | 9  |
| 2.1.  | Kategoria e Projektit të Propozuar .....                                                                                              | 9  |
| 2.2.  | Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....                                                                         | 9  |
| 2.3.  | Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit .....                                                             | 10 |
| 2.4.  | Përshkrimi detaj i procesit të planifikimit të prodhimit .....                                                                        | 10 |
| 2.5.  | Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme .....                                                                          | 11 |
| 2.6.  | Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....                              | 13 |
| 2.7.  | Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave .....                | 13 |
| 2.8.  | Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit .....                   | 13 |
| 2.9.  | Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme .....                                                                                        | 14 |
| 2.10. | Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....             | 15 |
| 2.11. | Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin .....                                                                    | 15 |
| 2.12. | Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese .....                                             | 15 |
| 3.    | PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....                                                                                             | 16 |
| 3.1.  | Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti .....                                                      | 16 |
| 3.2.  | Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit .....                                                                               | 16 |
| 3.3.  | Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi ..... | 17 |
| 3.4.  | Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit .....            | 18 |
| 3.5.  | Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë .....                                                                                       | 19 |
| 3.6.  | Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik ....                                                  | 20 |
| 3.7.  | Prezantimi i karakteristikat natyrore .....                                                                                           | 20 |
| 3.8.  | Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit.....                                                                               | 21 |
| 3.9.  | Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike.....                                                         | 21 |
| 3.10. | Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar .....        | 22 |

|       |                                                                                                                                                                                                                                          |    |
|-------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 3.11. | Të dhëna për objektet ekzistuese .....                                                                                                                                                                                                   | 22 |
| 3.12. | Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkelogjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme..... | 22 |
| 3.13. | Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj                                                                                                                                                    | 23 |
| 4.    | GJENDJAAKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....                                                                                                                                                                                                 | 24 |
| 4.1.  | Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor .....                                                                                                                                                                                  | 24 |
| 5.    | PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT.....                                                                                                                                                                                             | 25 |
| 5.1.  | Përshkrimi i alternativave të realizueshme .....                                                                                                                                                                                         | 25 |
| 5.2.  | Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një laternative të caktuar duke ju referuar .....                                                                                  | 26 |
| 5.3.  | Vendndodhja ose rruga.....                                                                                                                                                                                                               | 26 |
| 5.4.  | Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....                                                                                                                                                                                          | 26 |
| 5.5.  | Proceset dhe teknologjia e prodhimit.....                                                                                                                                                                                                | 27 |
| 5.6.  | Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit.....                                                                                                                                                                        | 27 |
| 5.7.  | Plani i lokacionit .....                                                                                                                                                                                                                 | 28 |
| 5.8.  | Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit .....                                                                                                                                                                   | 28 |
| 5.9.  | Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit.....                                                                                                                                        | 29 |
| 5.10. | Madhësia e lokacionit ose objektit.....                                                                                                                                                                                                  | 29 |
| 5.11. | Vëllimi i prodhimit.....                                                                                                                                                                                                                 | 29 |
| 5.12. | Kontrolli i ndotjes .....                                                                                                                                                                                                                | 29 |
| 5.13. | Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar.....                                                                                                                                  | 30 |
| 5.14. | Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit                                                                                                                                                    | 30 |
| 5.15. | Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit .....                                                                                                                                                                              | 30 |
| 5.16. | Trajnimi.....                                                                                                                                                                                                                            | 30 |
| 5.17. | Monitorimi .....                                                                                                                                                                                                                         | 30 |
| 5.18. | Planet për situata emergjente .....                                                                                                                                                                                                      | 30 |
| 5.19. | Demolimi dhe rehabilitimi .....                                                                                                                                                                                                          | 31 |
| 5.20. | Plani për menaxhimin e mjedisit.....                                                                                                                                                                                                     | 31 |
| 5.21. | Përshkrimi i alternativës pa veprim .....                                                                                                                                                                                                | 32 |

|       |                                                                                                                                                                                                   |    |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 6.    | PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS .....                                                                                                                                                | 33 |
| 6.1   | Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë .....                                                                                                                                     | 33 |
| 6.2.  | Cilësinë e ajrit .....                                                                                                                                                                            | 33 |
| 6.3.  | Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi.....                                         | 34 |
| 6.4.  | Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike .....                                                         | 34 |
| 6.5.  | Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit .....                                                                                                                                       | 35 |
| 6.6.  | Cilësia e ujit .....                                                                                                                                                                              | 35 |
| 6.7.  | Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore .....                                                                                                                      | 35 |
| 6.8.  | Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave .....                                                                                                                                     | 36 |
| 6.9.  | Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza .....                                                                                    | 36 |
| 6.10. | Toka.....                                                                                                                                                                                         | 36 |
| 6.11. | Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës                                                                                                             | 37 |
| 6.12. | Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës..... | 37 |
| 6.13. | Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore .....                                                                                                                                       | 38 |
| 6.14. | Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur .....                                                                                                                                               | 38 |
| 6.15. | Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike .....                                                                                                                                 | 38 |
| 6.16. | Popullsia lokale .....                                                                                                                                                                            | 39 |
| 6.17. | Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi .....                                                                    | 39 |
| 6.18. | Ndikimet vizuale të vendbanimeve.....                                                                                                                                                             | 39 |
| 6.19. | Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut .....                                                                    | 39 |
| 6.20. | Ndikimet socio-ekonomike .....                                                                                                                                                                    | 40 |
| 6.21. | Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës.....                                                                                    | 40 |
| 6.22. | Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura                       |    |

|       |                                                                                                                                                                                                                                                       |    |
|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 6.23. | Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare .....                                                                                                                                                                                      | 41 |
| 6.24. | Ekosistemet dhe gjeologjia .....                                                                                                                                                                                                                      | 41 |
| 6.25. | Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre .....                                                                                                                                                                        | 41 |
| 6.26. | Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversitetit, florës dhe faunës, pjesë të natyrorë të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve për egra dhe habitateve të tyre ..... | 41 |
| 6.27. | Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve .....                                                                                                                                                                                                           | 42 |
| 6.28. | Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara .....                                                                                                                                                                                                      | 42 |
| 6.29. | Shfrytëzimi i tokës .....                                                                                                                                                                                                                             | 42 |
| 6.30. | Infrastruktura komunale .....                                                                                                                                                                                                                         | 43 |
| 6.31. | Trafiku .....                                                                                                                                                                                                                                         | 43 |
| 6.32. | Furnizimi me ujë .....                                                                                                                                                                                                                                | 43 |
| 6.33. | Energjia .....                                                                                                                                                                                                                                        | 44 |
| 6.34. | Ujërat e zeza .....                                                                                                                                                                                                                                   | 44 |
| 6.35. | Gjenerimi i mbeturinave .....                                                                                                                                                                                                                         | 44 |
| 6.36. | Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit ...                                                                                                                                                                | 45 |
| 6.37. | Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga .....                                                                                                                                                 | 45 |
| 6.38. | Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit .....                                                                                                                                                                            | 45 |
| 6.39. | Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese .....                                                                                                                                                                                           | 46 |
| 6.40. | Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis .....                                                                                                                                                                      | 46 |
| 6.41. | Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit .....                                                                                                                                                                                         | 46 |
| 6.42. | Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit .....                                                                                                                                                                                           | 46 |
| 6.43. | Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit .....                                                                                                                                                                                                | 46 |
| 6.44. | Ndikimet në ndryshimet klimatike .....                                                                                                                                                                                                                | 47 |
| 7.    | PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS .....                                                                                                                                                              | 48 |
| 7.1.  | Masat e parashikuara me legjislacion .....                                                                                                                                                                                                            | 48 |
| 7.2.  | Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha .....                                                                                                                                                                               | 48 |
| 7.3.  | Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit .....                                                                                                                                                                                           | 49 |
| 7.4.  | Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis .....                                                                                                                                | 49 |
| 8.    | PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS .....                                                                                                                                                                                                    | 51 |
| 8.1.  | Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis .....                                                                                                                                                                                                    | 51 |

|       |                                                                                                                                 |    |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 8.2.  | Gjendja mjedisore para fillimit të projektit.....                                                                               | 51 |
| 8.3.  | Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis ...                                                | 51 |
| 8.4.  | Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar .....                                                      | 51 |
| 8.5.  | Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera .....                                                      | 52 |
| 8.6.  | Detyrimin për informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera.....                                                        | 52 |
| 8.7.  | Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis .....                                                                | 52 |
| 9.    | PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....                                                                                                | 53 |
| 9.1.  | Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit .....                                                              | 53 |
| 9.2.  | Pajtushmeria me pëlqim mjedisor.....                                                                                            | 53 |
| 9.3.  | Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000 .....                           | 54 |
| 10.   | INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT .....                                                                      | 55 |
| 10.1. | Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së, ..... | 55 |
| 10.2. | Baza ligjore dhe rregullative .....                                                                                             | 55 |
| 10.3. | Dokumentacioni teknik i projektit .....                                                                                         | 56 |
| 11.   | BURIMET E TË DHËNAVE.....                                                                                                       | 57 |
| 11.1. | Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së .....       | 57 |
| 12.   | SHTOJCA.....                                                                                                                    | 57 |
| 13.   | PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT.....                                                                                     | 58 |
| 13.1. | Hyrje.....                                                                                                                      | 58 |
| 13.2. | Përshkrimi i projektit .....                                                                                                    | 58 |
| 13.3. | Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse .....                                                                           | 58 |
| 13.4. | Përfitimet socio-ekonomike .....                                                                                                | 59 |
| 13.5. | Përfundim.....                                                                                                                  | 59 |

## Lista e Figurave

|           |                                                                                    |    |
|-----------|------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Figura 1. | Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Suharekës | 17 |
| Figura 2. | Distanca e kompanisë me qytetin e Suharekës .....                                  | 17 |
| Figura 3. | Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi .....                                       | 18 |
| Figura 4. | Distanca nga lumi Mirusha.....                                                     | 23 |
| Figura 5. | Plani i vendosjen se imipantit .....                                               | 28 |

## **1. HYRJE**

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për projektin e propozuar për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Aktualisht impianti nuk është i ndërtuar dhe aktiviteti nuk është në funksion, por planifikohet të realizohet me qëllim përpunimin mekanik të gurit gëlqeror dhe prodhimin e fraksioneve granulometrike për nevoja të ndërtimtarisë dhe tregut. Qëllimi i këtij raporti është të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedis që mund të paraqiten gjatë fazës së ndërtimit, instalimit të pajisjeve, funksionalizimit dhe operimit të impiantit, si dhe të propozojë masa konkrete për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve. Projekti i propozuar përfshin vendosjen e pajisjeve për thërrmim, sitje, separim dhe klasifikim të materialit gëlqeror sipas fraksioneve të ndryshme. Materiali gëlqeror që do të përpunohet në këtë impiant planifikohet të sigurohet nga aktiviteti i eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani, projekt i cili gjithashtu është në fazë planifikimi dhe ende nuk është realizuar në terren. Pas nxjerrjes nga zona e eksploatimit, materiali do të transportohet drejt impiantit të planifikuar, ku do t’i nënshtrohet përpunimit mekanik përmes proceseve të thërrmimit dhe separimit. Produkti final do të deponohet përkohësisht në hapësira të caktuara brenda lokacionit, deri në përdorimin ose transportimin e tij për nevoja të tregut. Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurën e VNM-së. Në kuadër të raportit janë trajtuar komponentët kryesorë mjedisorë, përfshirë tokën, ajrin, ujin, biodiversitetin, peizazhin, zhurmën, menaxhimin e mbeturinave, sigurinë gjatë punës, trafikun dhe aspektet socio-ekonomike. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndikimeve potenciale që mund të paraqiten nga realizimi i projektit, sidomos emetimit të pluhurit gjatë thërrmimit, sitjes, manipulimit dhe deponimit të materialit, zhurmës nga pajisjet dhe makineritë, lëvizjes së mjeteve transportuese, menaxhimit të ujërave atmosferike dhe organizimit të hapësirës operative të impiantit. Për secilin ndikim të mundshëm janë propozuar masa parandaluese dhe menaxhuese, me qëllim që projekti të realizohet dhe të operojë në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe me ndikim sa më të ulët në mjedisin përreth. Ky dokument do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit nga autoritetet kompetente lidhur me pajisjen me pëlqim mjedisor, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe masave që duhet të zbatohen gjatë ndërtimit, instalimit dhe funksionimit të impiantit të planifikuar. Në këtë mënyrë synohet që projekti të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, standardet teknike dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.



## **2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR**

### **2.1.Kategoria e Projektit të Propozuar**

Projekti i propozuar për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, i takon kategorisë së projekteve për shfrytëzim dhe përpunim mekanik të materialeve minerale ndërtimore. Aktiviteti kryesor i projektit përfshin përpunimin mekanik përmes thërrmimit, seperimit dhe klasifikimit granulometrik. Në lokacionin e impiantit do të zhvillohet procesi teknologjik i përpunimit mekanik të materialit, i cili përfshin pranimin e gurit gëlqeror, futjen në pajisjet thërrmuese, thërrmimin, seperimin sipas fraksioneve granulometrike dhe deponimin e përkohshëm të produktit final. Projekti, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i nënshtrohet procedurës së VNM-së për shkak të natyrës së aktivitetit dhe mundësisë për ndikime në komponentët mjedisorë. Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me gjenerimin e pluhurit gjatë thërrmimit, seperimit, ngarkimit dhe shkarkimit të materialit, si dhe me krijimin e zhurmës dhe vibrimeve nga përdorimi i makinerive, pajisjeve dhe mjeteve transportuese. Duke marrë parasysh karakterin e aktivitetit dhe mënyrën e zhvillimit të tij, projekti konsiderohet me ndikim potencial në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit. Megjithatë, këto ndikime janë të menaxhueshme përmes zbatimit të masave parandaluese, teknike dhe organizative të përcaktuara në këtë raport.

### **2.2.Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit**

Punët përgatitore për zbatimin e projektit përfshijnë aktivitetet që do të realizohen para ndërtimit dhe funksionalizimit të impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror. Meqenëse impianti nuk është ende i ndërtuar, faza përgatitore do të ketë rëndësi të veçantë për organizimin e lokacionit, vendosjen e pajisjeve dhe krijimin e kushteve teknike për zhvillimin e sigurt të aktivitetit. Në këtë fazë parashihej pastrimi dhe rregullimi i sipërfaqes së lokacionit ku do të vendoset impianti, largimi i materialeve të panevojshme, nivelimi i terrenit aty ku është e nevojshme, si dhe përcaktimi i zonave funksionale brenda hapësirës së projektit. Këto zona do të përfshijnë hapësirën për vendosjen e pajisjeve të thërrmimit dhe separimit, hapësirat për pranimin e materialit gëlqeror, hapësirat për deponimin e përkohshëm të fraksioneve të prodhuara, rrugët e brendshme për qarkullimin e mjeteve, si dhe hapësirat ndihmëse për nevojat operative të projektit. Gjithashtu, gjatë fazës përgatitore do të bëhet organizimi i qasjes në lokacion, rregullimi i rrugëve të brendshme operative, sigurimi i hapësirës për lëvizjen e makinerive dhe mjeteve transportuese, si dhe vendosja e masave fillestare për kontrollin e pluhurit dhe menaxhimin e ujërave atmosferike. Kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet shmangies

së shpërndarjes së materialit jashtë zonës së projektit, ruajtjes së stabilitetit të terrenit dhe organizimit të punimeve në mënyrë që ndikimet në mjedisin përreth të jenë sa më të ulëta. Në këtë fazë mund të përfshihet edhe sjellja e pajisjeve teknologjike në lokacion, montimi i impiantit, vendosja e sitave, transportierëve, bunkerëve dhe pajisjeve ndihmëse, si dhe lidhja e tyre me sistemet e nevojshme për funksionim. Pas përfundimit të punëve përgatitore dhe instalimit të pajisjeve, do të bëhet testimi teknik i impiantit para fillimit të operimit të rregullt.

### **2.3.Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit**

Projekti i propozuar përfshin ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Impianti planifikohet të funksionojë si njësi për përpunimin mekanik të materialit gëlqeror, përmes të cilit materiali i nxjerrë do të thërrmohet, sitohe dhe ndahet në fraksione të ndryshme granulometrike. Funksionimi i projektit do të bazohet në pranimin e materialit gëlqeror, ngarkimin e tij në pajisjet e thërrmimit, kalimin nëpër sistemin e sitjes dhe seperimit, si dhe deponimin e përkohshëm të produktit final në hapësirat e caktuara brenda lokacionit. Procesi nuk përfshin trajtim kimik, djegie, larje industriale apo përdorim të substancave të rrezikshme, por vetëm përpunim mekanik të gurit gëlqeror. Materiali që do të përpunohet në impiant planifikohet të sigurohet nga projekti i eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani. Pas nxjerrjes së gurit gëlqeror nga zona e eksploatimit, materiali do të transportohet me mjete përkatëse deri te impianti i planifikuar për thërrmim dhe seperim.

Karakteristikat kryesore të funksionimit të impiantit do të lidhen me punën e pajisjeve mekanike, si thërrmuesit, sitat vibruese, transportierët, bunkerët dhe pajisjet ndihmëse për bartjen dhe klasifikimin e materialit. Gjatë operimit pritet të krijohen ndikime të mundshme si pluhur, zhurmë, vibrime lokale nga pajisjet, lëvizje të mjeteve transportuese dhe krijim i ujërave atmosferike nga sipërfaqet operative. Për këtë arsye, funksionimi i impiantit do të organizohet në mënyrë të kontrolluar, duke zbatuar masa për spërkatjen e sipërfaqeve me ujë në periudha të thata, mirëmbajtjen e pajisjeve, kufizimin e shpejtësisë së mjeteve, rregullimin e rrugëve të brendshme, menaxhimin e deponimit të përkohshëm të materialit dhe kontrollin e zhurmës gjatë punës së pajisjeve.

### **2.4.Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit**

Procesi teknologjik i impiantit të planifikuar për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror do të zhvillohet në mënyrë të thjeshtë dhe mekanike, duke filluar nga sigurimi i lëndës së parë deri te fitimi i produktit përfundimtar. Lënda e parë për këtë impiant do të jetë guri gëlqeror, i cili planifikohet të nxirret nga zona e eksploatimit e kompanisë “StoneX Holding” SH.P.K. Pas

arritjes së gurit gëlqeror në impiant, do të shkarkohet në hapësirën e pranimit të lëndës së parë ose në bunkerët hyrës të impiantit, prej nga do të futet në linjën teknologjike të përpunimit. Në fazën kryesore të procesit, materiali do të kalojë në thërmues, ku guri gëlqeror do të copëtohet dhe do të zvogëlohet në përmasa më të vogla. Ky proces bëhet vetëm me veprim mekanik. Materiali i thërrmuar më pas do të bartet me shirita transportues drejt sitave, ku do të bëhet ndarja e tij sipas madhësisë së kokrrizave. Gjatë sitjes dhe seperimit, materiali do të ndahet në fraksione të ndryshme granulometrike, varësisht nga kërkesat teknike dhe përdorimi i tij në treg. Pjesa e materialit që nuk arrin madhësinë e kërkuar do të kthehet përsëri në procesin e thërrmimit, deri sa të fitohet fraksioni i përshtatshëm. Materiali që plotëson madhësinë e kërkuar do të kalojë përmes shiritave transportues në hapësirat e caktuara për deponim të përkohshëm. Fraksionet e gatshme të gurit gëlqeror do të deponohen ndaras brenda lokacionit të impiantit, në mënyrë që të mos përzihen mes vete. Pas deponimit të përkohshëm, produkti final do të ngarkohet me eskavator në kamionë dhe do të transportohet jashtë lokacionit për përdorim në ndërtimtari, infrastrukturë rrugore, prodhim betoni, asfalt apo qëllime të tjera teknike. Në përgjithësi, rrjedha e procesit teknologjik do të jetë: nxjerrja e gurit gëlqeror, ngarkimi, transportimi deri te impianti, shkarkimi në bunker, thërrmimi, bartja me shirita transportues, sitja dhe seperimi, ndarja në fraksione, deponimi i përkohshëm, ngarkimi dhe transportimi i produktit final.

### **2.5.Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme**

Për realizimin e projektit të propozuar për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nevojiten burime natyrore, teknike, materiale dhe njerëzore, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me fazën e ndërtimit, instalimit të pajisjeve dhe funksionimit të impiantit.

Aktiviteti i planifikuar nuk përfshin prodhim kimik apo trajtim industrial të materialit, por vetëm përpunim mekanik të gurit gëlqeror përmes thërrmimit, sitjes, separimit dhe klasifikimit sipas fraksioneve granulometrike. Materiali që do të përpunohet në impiant do të sigurohet nga zona e eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani, projekt i cili është gjithashtu në fazë planifikimi.

**Burimi kryesor** për funksionimin e impiantit është guri gëlqeror. Ky material do të nxirret nga zona e eksploatimit të planifikuar dhe do të transportohet në impiantin e thërrmimit dhe separimit. Në impiant, materiali do t’i nënshtrohet përpunimit mekanik për prodhimin e fraksioneve të ndryshme, të cilat do të përdoren për nevoja të ndërtimtarisë dhe tregut.

Sasia e materialit që do të përpunohet do të varet nga kapaciteti teknik i pajisjeve, kërkesat e tregut dhe dinamika e eksploatimit. Përpunimi do të bëhet në mënyrë të kontrolluar, brenda kapaciteteve të lejuara dhe sipas kushteve teknike të përcaktuara për funksionimin e impiantit.

**Burimet teknike dhe pajisjet** - Për realizimin e aktivitetit nevojiten pajisje dhe makineri të specializuara për përpunimin mekanik të materialit gëlqeror. Pajisjet kryesore që pritet të përdoren janë: impiante për thërrmim të materialit gëlqeror, sita për ndarjen e fraksioneve, shirita transportues, pajisje për separim dhe klasifikim, ngarkues, ekskavatorë, kamionë për transport të materialit, si dhe pajisje ndihmëse për mirëmbajtje dhe organizim të hapësirës operative.

Këto pajisje do të përdoren për pranimin e materialit nga zona e eksploatimit, thërrmimin e tij, ndarjen sipas madhësisë së kokrrizave, deponimin e përkohshëm të fraksioneve dhe ngarkimin për transport të mëtejshëm.

**Burimet energjetike** - Gjatë funksionimit të impiantit do të nevojitet energji për punën e pajisjeve të thërrmimit, sitjes, separimit, shiritave transportues dhe pajisjeve ndihmëse. Furnizimi me energji elektrike do të realizohet sipas mundësive teknike të lokacionit dhe kushteve të operatorit përkatës të rrjetit.

Në rastet kur pajisjet apo makineritë punojnë me derivate të naftës, do të përdoret naftë për ekskavatorë, ngarkues, kamionë dhe mjete të tjera lëvizëse. Ruajtja dhe përdorimi i derivateve duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, për të parandaluar rrjedhjet aksidentale dhe ndotjen e tokës apo ujërave sipërfaqësore.

**Burimet ujore** - Uji mund të nevojitet kryesisht për spërkatjen e sipërfaqeve të punës, rrugëve të brendshme, zonave të deponimit dhe materialit gjatë periudhave të thata, me qëllim zvogëlimin e emetimit të pluhurit. Uji gjithashtu mund të përdoret për nevoja sanitare të punëtorëve dhe për pastrim të kufizuar të hapësirave operative.

Projekti nuk parasheh përdorim të ujit si pjesë e procesit teknologjik të përpunimit të gurit gëlqeror, përveç rasteve kur aplikohet spërkatje për kontroll të pluhurit. Sasia e ujit do të jetë e kufizuar dhe do të varet nga sezoni, kushtet atmosferike dhe intensiteti i punës së impiantit.

**Materialet ndihmëse** Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit të impiantit do të nevojiten materiale ndërtimore dhe teknike, si beton, armaturë, zhavorr, elemente metalike, kablllo elektrike, pjesë montuese dhe materiale të tjera ndihmëse për vendosjen e pajisjeve dhe rregullimin e hapësirës operative.

Gjatë fazës së operimit do të nevojiten materiale për mirëmbajtje, si vajra lubrifikues, pjesë rezervë, goma, filtra, mjete pune dhe pajisje mbrojtëse për punëtorët. Këto materiale duhet të ruhen në vende të përshtatshme dhe të menaxhohen në mënyrë të sigurt.

**Burimet njerëzore** - Për funksionimin e impiantit do të nevojitet staf teknik dhe operativ, përfshirë operatorë të pajisjeve të thërrmimit dhe separimit, shoferë, punëtorë për ngarkim dhe organizim të materialit, personel për mirëmbajtje mekanike dhe elektrike, si dhe person përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Numri i punëtorëve do të përcaktohet varësisht nga kapaciteti i impiantit, orari i punës dhe organizimi i procesit operativ. Të gjithë punëtorët duhet të jenë të pajisur me mjete personale mbrojtëse dhe të jenë të informuar për rreziqet gjatë punës, sidomos lidhur me pluhurin, zhurmën, lëvizjen e makinerive dhe sigurinë në zonën operative.

Në përgjithësi, burimet e nevojshme për këtë projekt janë të karakterit teknik dhe operativ, ndërsa përdorimi i tyre do të bëhet në mënyrë të kontrolluar. Me zbatimin e masave të përshtatshme për menaxhimin e pluhurit, zhurmës, ujërave atmosferike, derivateve dhe mbeturinave, ndikimi nga shfrytëzimi i këtyre burimeve mund të mbahet në nivel të pranueshëm mjedisor.

## **2.6. Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik**

Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit mund të krijohen mbeturina të zakonshme ndërtimore, si pjesë të materialeve të paketimit, mbetje metalike nga montimi i pajisjeve, mbetje plastike, dru, ambalazhe dhe mbeturina komunale nga punëtorët. Këto mbeturina duhet të grumbullohen në mënyrë të ndarë dhe të dorëzohen te operatorët e licencuar për trajtim apo riciklim.

Gjatë fazës së operimit, mbeturinat e vetme që gjenerohen janë mbeturina komunale që do të krijohen nga personeli që do të punojë në lokacion. Ato duhet të grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe të dorëzohen te ndërmarrja përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale.

## **2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave**

Projekti i propozuar për impiantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nuk parasheh proces të trajtimit kimik, riciklimit industrial apo asgjësimit të mbeturinave.

## **2.8. Programi kohor i ndërtimit dhe operimit të projektit dhe faza e rehabilitimit pas përfundimit të funksionimit**

Projekti i propozuar është në fazë planifikimi. Realizimi i projektit do të fillojë pas pajisjes me pëlqimin mjedisor dhe lejet e tjera të nevojshme nga autoritetet kompetente. Faza e parë do të përfshijë përgatitjen e lokacionit ku planifikohet të vendoset impianti. Në këtë fazë do të bëhet pastrimi i sipërfaqes, rregullimi i terrenit, organizimi i qasjes, përcaktimi i hapësirave për

lëvizjen e makinerive dhe përgatitja e zonave ku do të vendosen pajisjet teknologjike. Pas kësaj do të vazhdohet me sjelljen e pajisjeve në lokacion, montimin e thërmuesve, sitave, shiritave transportues, bunkerëve dhe pajisjeve ndihmëse. Kohëzgjatja e ndërtimit dhe instalimit të impiantit do të varet nga kushtet teknike, furnizimi me pajisje dhe organizimi i punimeve në terren, e cila është planifikur diku 3-6 muaj pas marrjes së pelqimit mjedisor. Në kushte normale, punët përgatitore dhe montimi i impiantit pritet të realizohen brenda një periudhe relativisht të shkurtër, pasi projekti nuk përfshin ndërtim kompleks industrial, por kryesisht përgatitje të bazës operative dhe instalim të pajisjeve mekanike. Pas përfundimit të montimit do të bëhet kontrolli teknik dhe testimi i impiantit. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave dhe plotësimit të kushteve ligjore, impianti do të fillojë funksionimin e rregullt.

Kohëzgjatja e planifikuar e funksionimit të projektit lidhet me jetëgjatësinë teknike të pajisjeve, kërkesat e tregut dhe furnizimin me material gëlqeror nga zona e eksploatimit e kompanisë. Gjatë gjithë periudhës së funksionimit, operatori duhet të zbatojë masat për mbrojtjen e mjedisit, mirëmbajtjen e pajisjeve, kontrollin e pluhurit, menaxhimin e mbeturinave dhe sigurinë në punë. Pas përfundimit të funksionimit të projektit, do të bëhet çmontimi i pajisjeve, largimi i materialeve të mbetura, pastrimi i lokacionit dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të përdorura. Rehabilitimi do të përfshijë nivelimin e terrenit, largimin e mbeturinave, kthimin e hapësirës në gjendje të sigurt dhe, sipas mundësisë, gjelbërimin e sipërfaqeve të lira. Qëllimi i rehabilitimit është që pas ndërprerjes së aktivitetit, lokacioni të mos paraqesë rrezik për mjedisin, për tokën, ujërat, peizazhin dhe komunitetin përreth.

## **2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme**

Për realizimin dhe funksionimin e impiantit të planifikuar për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror nevojitet infrastrukturë bazë teknike dhe operative, e cila do të mundësojë zhvillimin normal të aktivitetit. Kjo infrastrukturë përfshin qasjen rrugore, hapësirat për vendosjen e pajisjeve, rrugët e brendshme, furnizimin me energji, furnizimin me ujë, hapësirat për deponim të përkohshëm. Qasja në lokacion duhet të jetë e përshtatshme për lëvizjen e kamionëve dhe makinerive të rënda që do të përdoren për transportimin e materialit gëlqeror dhe produktit final. Rrugët e brendshme duhet të organizohen në mënyrë që të mundësojnë qarkullim të sigurt, shmangie të bllokimeve dhe ndarje të qartë të zonave të ngarkimit, shkarkimit dhe deponimit. Në lokacion do të nevojiten hapësira të veçanta për vendosjen e thërmuesit, sitave, shiritave transportues, bunkerëve dhe pajisjeve ndihmëse. Po ashtu, duhet të parashihen hapësira për pranimin e lëndës së parë dhe për deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gatshme. Deponimi duhet të bëhet në mënyrë të rregullt, me ndarje të qartë të materialeve sipas

granulometrisë. Furnizimi me energji elektrike do të jetë i nevojshëm për funksionimin e pajisjeve të impiantit. Uji do të nevojitet kryesisht për spërkatjen e rrugëve të brendshme, sipërfaqeve operative dhe materialit, me qëllim uljen e pluhurit gjatë ditëve të thata. Projekti nuk parasheh përdorim të ujit për larje industriale të gurit gëlqeror dhe nuk krijon ujëra teknologjike nga procesi i prodhimit.

#### **2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave**

Në kuadër të projektit nuk parashihet ndërtimi i kampeve, rezidencave apo objekteve të përhershme për akomodimin e punëtorëve. Aktiviteti zhvillohet në kushte të hapura dhe operimi realizohet nga personel që angazhohet në baza ditore. Punëtorët nuk qëndrojnë në lokacion jashtë orarit të punës dhe, rrjedhimisht, nuk ka nevojë për infrastrukturë banimi apo struktura të përkohshme rezidenciale.

#### **2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin**

Për impiantin e thërrmimit dhe seperimin e gurit gëlqeor, investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Lejet dhe licencat kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal** nga Komuna e Rahovecit për aktivitetin/lokacionin, sipas kompetencave komunale.
2. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)** dhe vendimi për Pelqim Mjedisor nga MMPHI.
3. **Licenca nga KPMM**
4. **Leja Mjedisore** nga MMPHI për operimin e aktivitetit.

#### **2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese**

Projekti për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ndërlidhet funksionalisht me projektin e planifikuar për eksploatimin e gurit gëlqeror nga e njëjta kompani. Ky projekt ka lidheshmeri me biznese tjera ndertimore.

### **3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR**

#### **3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti**

Projekti për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror “StoneX Holding” SH.P.K. është planifikuar të zbatohet në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Zona e projektit përfshin ngastrat kadastrale me numër:

- P-72116003-04427-0,
- P-72116003-04428-0,
- P-72116003-04429-0,
- P-72116003-04430-0, të gjitha në Zonën Kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës.


#### **3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit**

Vendndodhja e projektit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë përkatëse, të cilat ilustrjnë shtrirjen hapësinore të projektit në nivel kombëtar, komunal dhe lokal. Në hartën orientuese në nivel të Republikës së Kosovës paraqitet pozicioni i lokacionit në pjesën jugperëndimore të vendit, përkatësisht në territorin e Komunës së Suharekës. Kjo paraqitje mundëson identifikimin e qartë të vendndodhjes së projektit në kontekstin më të gjerë gjeografik. Në paraqitjen komunal dhe lokale është theksuar Zona Kadastrale Bllacë, ku ndodhen ngastrat kadastrale në të cilat planifikohet thërrmimi dhe seperimi i gurit gëlqeror. Harta tregon shtrirjen e projektit brenda territorit administrativ të Komunës së Suharekës, si dhe raportin e tij me vendbanimin Bllacë, rrugët ekzistuese, sipërfaqet pyjore dhe aktivitetet përreth. Në planimetrinë lokale janë paraqitur parcelat ku do të bëhet thërrmimi dhe seperimi i gurit gëlqeror, të evidentuara me sipërfaqe të theksuar. Kjo paraqitje tregon kufijtë e zonës së projektit, shtrirjen e parcelave brenda zonës kadastrale dhe lidhjen hapësinore të lokacionit me zonën përreth. Skica dhe planimetria shërbejnë si bazë për identifikimin e zonës së ndikimit dhe për vlerësimin e kushteve mjedisore në lokacion.





vendbanimet më të afërta. Vendbanimi më i afërt është Bllaca, e cila ndodhet në distancë rreth 1.01km nga zona e projektit, varësisht nga pika e matjes. Ndërsa vendbanimi Nishor ndodhet në distancë rreth 2.25 km nga lokacioni i projektit.



*Figura 3. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi*

### **3.4. Paraqitje e karakteristikat pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit**

Komuna e Suharekës karakterizohet me llojllojshmëri të theksuar natyrore, ku përfshihen zona fushore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës paraqet kushte të ndryshme pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike dhe hidrogeologjike, të cilat janë rezultat i ndërtimit gjeologjik, relievit, rrjedhave ujore dhe proceseve natyrore të zhvilluara gjatë kohës. Nga aspekti pedologjik, në këtë territor paraqiten grupe të ndryshme të tokave, të cilat i japin komunës pamje mozaike pedologjike. Përveç tokave skeletore, të cilat paraqiten në vendet shkëmbore, tokat tjera janë formuar nga sedimente liqenore, bartje lumore dhe depozitime të reja nga rrjedhat ujore. Në territorin e komunës hasen edhe pseudoglejet, të cilat paraqiten në sipërfaqe më të kufizuara dhe kanë bonitet kryesisht të klasës IV–VI. Po ashtu, përgjatë luginave të lumenjve janë të pranishme tokat aluviale, të cilat konsiderohen ndër tokat më produktive për bujqësi. Tokat bujqësore të kategorive I, II, III dhe IV kanë rëndësi të veçantë dhe përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes së komunës. Nga aspekti geomorfologjik, Komuna e Suharekës shtrihet ndërmjet pjesëve kodrinore e malore dhe hapësirave më të ulëta fushore që lidhen me Rrafshin e Dukagjinit dhe fushën e Prizrenit. Terreni në pjesë të ndryshme të komunës paraqitet me shpate, ngritje kodrinore, lugina lumore dhe sipërfaqe më të rrafshëta. Në veri dhe lindje të komunës terreni ka ngritje më të theksuar, ndërsa në drejtim të jugut dhe perëndimit hapen sipërfaqe më të përshtatshme për zhvillim bujqësor dhe vendbanime. Kushtet

geomorfologjike në përgjithësi janë të ndryshme, por të përshtatshme për zhvillim të kontrolluar, duke marrë parasysh pjerrësitë, stabilitetin e terrenit dhe rrezikun nga erozioni. Nga aspekti gjeologjik, Komuna e Suharekës ka ndërtim të ndryshëm gjeologjik. Pjesët veriore të komunës përbëhen kryesisht nga mergel, argjilë, argjilë me thëngjill, gëlqerorë dhe formacione të tjera sedimentare. Në rrethinën e Carralevës paraqiten formacione të flishit të shkumësit të epërm, ndërsa në disa pjesë hasen edhe diabaz, serpentine dhe peridotite të serpentinizuara. Në pjesën juglindore të komunës paraqiten rrasat e gjelbërta, metabazite, amfibolite, ndërsa në jug hasen edhe gëlqerorë dhe dolomite. Kjo përbërje gjeologjike tregon se komuna ka potencial të konsiderueshëm për materiale minerale dhe ndërtimore, përfshirë edhe gurin gëlqeror. Nga aspekti hidrogeologjik dhe hidrografik, Komuna e Suharekës ka rrjet të zhvilluar të lumenjve dhe përroskave. Rrjedhat ujore kanë karakter kryesisht malor dhe sezonal, me ndryshime të mëdha të prurjeve gjatë vitit. Në periudhat e thata disa rrjedha kanë pak ujë ose thahen, ndërsa gjatë reshjeve intensive mund të shkaktojnë vërshime lokale. Lumi kryesor i komunës është Toplluha, i cili formohet nga burimet dhe përroskat që vijnë nga Qafa e Duhlës, Malet e Budakovës, Pagarusha dhe Nishori. Toplluha është degë e majtë e Drinit të Bardhë dhe paraqet arterien kryesore hidrografike të komunës. Përveç tij, rëndësi kanë edhe lumi i Sopisë, Lumi i Bardhë, Lumi i Bllacës dhe disa përroska lokale. Në aspektin hidrogeologjik, terrenet me gëlqerorë, dolomite dhe formacione të çara mundësojnë qarkullim të ujërave nëntokësore, ndërsa zonat me argjilë dhe mergel kanë përshkueshmëri më të ulët. Nga aspekti sizmologjik, Komuna e Suharekës, sikurse pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, ndodhet në zonë me aktivitet sizmik të mundshëm. Rajoni jugperëndimor i Kosovës lidhet me ndikime tektonike rajonale, prandaj gjatë planifikimit të ndërtimeve, zhvillimeve infrastrukturore dhe aktiviteteve minerare duhet të merren parasysh kushtet e stabilitetit të terrenit, pjerrësitë, përbërja gjeologjike dhe masat për siguri teknike. Në zonat kodrinore dhe malore vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet stabilitetit të skarpave, erozionit dhe rrëshqitjeve të mundshme të tokës.

### **3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë**

Në kuadër të projektit për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, uji do të përdoret për spërkatjen e sipërfaqeve, uji do të merret nga pusi i cili është planifikuar të hapet.

### **3.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik**

Komuna e Suharekës karakterizohet me klimë kontinentale me ndikim mesdhetar, për shkak të pozitës së saj në pjesën jugore të Kosovës dhe afërsisë me rajonin e Prizrenit. Kjo klimë shprehet me vera relativisht të ngrohta dhe të thata, dimra të ftohtë, si dhe reshje të shpërndara gjatë vitit. Sipas të dhënave të PZHK-së së Suharekës, temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është rreth 11°C, ndërsa maksimumi absolut paraqitet në muajin gusht me 38.2°C. Lagështia mesatare relative vjetore e ajrit në Suharekë është rreth 74.3%, ndërsa lagështia më e ulët paraqitet gjatë muajit gusht, me rreth 63.2%. Vranësira mesatare vjetore është rreth 5.0 të dhjetat e qiellit, ndërsa vranësira më e ulët paraqitet në muajin gusht, me vlerë rreth 2.7. Sa i përket reshjeve, Komuna e Suharekës ka regjim të reshjeve që ndikohet nga pozita gjeografike, relievi dhe afërsia me zonat malore. Reshjet janë më të theksuara gjatë periudhave të lagështa të vitit, ndërsa gjatë verës mund të paraqiten periudha më të thata. Për zonat urbane të Suharekës, në dokumentacionin planifikues janë përdorur vlera mesatare shumëvjeçare të reshjeve prej rreth 593 mm/vit, ndërsa në studime agroklimatike për zonën e Suharekës përmenden edhe vlera rreth 695 mm/vit, varësisht nga periudha dhe metodologjia e matjes. Këto karakteristika klimatike janë të rëndësishme për vlerësimin e ndikimeve mjedisore, sidomos për projektet minerare dhe aktivitetet në terren të hapur. Temperaturat e larta dhe periudhat e thata mund të ndikojnë në rritjen e pluhurit gjatë lëvizjes së makinerive dhe transportit, ndërsa reshjet intensive mund të ndikojnë në rrjedhjet sipërfaqësore, erozionin dhe bartjen e materialit të imët nga sipërfaqet e hapura. Për këtë arsye, gjatë operimit duhet të zbatohen masa për lagjen e rrugëve të brendshme, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe stabilizimin e sipërfaqeve të ekspozuara.

### **3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore**

Komuna e Suharekës karakterizohet me kushte të larmishme natyrore, ku ndërthuren zona fushore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës përfshin sipërfaqe bujqësore, pyjore, kullosa, rrjedha ujore dhe zona me vlera natyrore e peizazhore. Këto karakteristika e bëjnë komunën të rëndësishme si për zhvillim ekonomik, ashtu edhe për ruajtjen e mjedisit natyror. Në pjesët më të ulëta dhe fushore të komunës dominojnë tokat bujqësore dhe vendbanimet, ndërsa në pjesët kodrinore dhe malore paraqiten sipërfaqe pyjore, terrene me pjerrësi dhe zona natyrore më pak të urbanizuara. Sipas PZHK-së së Suharekës, në planifikimin zhvillimor të komunës rëndësi e veçantë i kushtohet mbrojtjes së resurseve natyrore, tokës bujqësore, pyjeve, ujërave dhe llojllojshmërisë së peizazheve natyrore. Rrjeti hidrografik i komunës përbëhet nga lumi Toplluha dhe degët e tij, si dhe nga përroska e rrjedha më të vogla sezonale. Këto rrjedha



kanë rëndësi për ekuilibrin natyror, bujqësinë dhe kullimin e ujërave sipërfaqësore. Në periudhat me reshje intensive mund të paraqiten prurje më të larta, ndërsa gjatë periudhave të thata disa rrjedha kanë prurje të ulët. Bimësia natyrore është e lidhur ngushtë me relievin dhe llojin e tokës. Në zonat kodrinore dhe malore paraqiten kryesisht sipërfaqe pyjore dhe shkurre, ndërsa në zonat më të ulëta dominojnë kultura bujqësore, livadhe dhe sipërfaqe të shfrytëzuara nga banorët lokalë. Fauna është tipike për zonat rurale, pyjore dhe kodrinore të Kosovës, me prani të shpendëve, gjitarëve të vegjël, zvarranikëve dhe llojeve të tjera të përshtatura me këto habitate.

### **3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit**

Peizazhi i Komunës së Suharekës ka karakter të përzier rural, bujqësor, kodrinor dhe malor. Në pjesët e ulëta të komunës dominojnë fushat bujqësore, vendbanimet dhe infrastruktura rrugore, ndërsa në pjesët më të ngritura paraqiten shpate kodrinore, sipërfaqe pyjore, kullosa dhe zona natyrore me ndikim më të ulët urban. Karakteri i peizazhit ndryshon nga zona në zonë. Në afërsi të vendbanimeve peizazhi është më i ndikuar nga aktivitetet njerëzore, si bujqësia, banimi, rrugët dhe objektet ekonomike. Në zonat kodrinore dhe pyjore peizazhi ruan karakter më natyror, me pamje të hapura, reliev të thyer dhe mbulesë bimë më të dendur. PZHK e Suharekës e trajton ruajtjen e llojllojshmërisë së peizazheve natyrore si pjesë të rëndësishme të planifikimit hapësinor dhe mjedisor të komunës. Kjo nënkupton se gjatë zhvillimit të projekteve duhet të merren parasysh ndikimet vizuale, ndryshimi i relievit, dëmtimi i sipërfaqeve pyjore dhe ruajtja e harmonisë së peizazhit me mjedisin përreth. Në zonat ku zhvillohen aktivitete, peizazhi mund të pësojë ndryshime si rezultat i hapjes së fronteve të punës, largimit të vegjetacionit, krijimit të rrugëve të brendshme dhe ndryshimit të konfiguracionit natyror të terrenit.

### **3.9. Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike**

Në zonën ku do të bëhet thërrmimi dhe sperimi I gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike brenda ngastrave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre. Në rast se gjatë punimeve hasen gjurmë apo elemente të mundshme arkeologjike, kompania duhet të ndërpresë punimet në atë pjesë dhe të njoftojë institucionet kompetente për trashëgimi kulturore.

### **3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar**

Komuna e Suharekës ka karakter kryesisht urban, rural dhe bujqësor, me popullsi të shpërndarë në qytetin e Suharekës dhe në vendbanimet përreth. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në regjistrimin e vitit 2011 Komuna e Suharekës kishte 59,722 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2024 popullsia ka shënuar rënie në rreth 45,749 banorë. Nga aspekti demografik, komuna karakterizohet me vendbanime rurale dhe urbane, me aktivitet ekonomik të lidhur kryesisht me bujqësinë, tregtinë, shërbimet, ndërtimtarinë dhe veprimtaritë prodhuese. Projekti i planifikuar nuk pritet të shkaktojë zhvendosje të popullsisë apo ndryshim të strukturës demografike të zonës. Ndikimi kryesor i mundshëm lidhet me shqetësimet e përkohshme gjatë operimit, të cilat do të menaxhohen përmes masave për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve dhe qarkullimit të kamionëve.

### **3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese**

Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit ku planifikohet thërrmimi dhe seperimi I gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk ka objekte banimi apo objekte të tjera të ndjeshme. Shtëpitë më të afërta të banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km nga zona e projektit, prandaj ndikimet e drejtpërdrejta nga aktiviteti minerar në popullsinë lokale pritet të jenë të kufizuara

### **3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përrshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme**

Bazuar në dokumentacionin planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, në hapësirën ku planifikohet thërrmimi dhe seperimi i gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., nuk janë identifikuar zona të përcaktuara për kërkime shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore apo zona me qëllime të veçanta brenda ngastrave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre.

### 3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj

Sipas paraqitjes hartografike, rrjedha ujore më e afërt është **Lumi Mirushë**, i cili ndodhet në distancë rreth **1.20 km** nga zona e projektit. Kjo distancë konsiderohet e mjaftueshme për të kufizuar ndikimet e drejtpërdrejta në rrjedhën ujore. Në sipërfaqen ku planifikohet realizimi i projektit nuk parashihet shfrytëzim i burimeve ujore për qëllime teknologjike apo prodhuese. Uji do të përdoret vetëm për spërkatjen e sipërfaqeve të punës dhe rrugëve të brendshme, me qëllim uljen e pluhurit gjatë zhvillimit të aktiviteteve në impiant.



Figura 4. Distanca nga lumi Mirusha

#### **4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR**

##### **4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor**

Gjendja aktuale e faktorëve mjedisorë paraqitet e ndikuar nga zhvillimi urban, trafiku rrugor, aktivitetet ekonomike, bujqësia, shfrytëzimi i tokës, si dhe nga kushtet natyrore të territorit. Komuna e Suharekës karakterizohet me zona urbane, rurale, bujqësore, kodrinore dhe malore, ku ndikimet mjedisore ndryshojnë varësisht nga pozita, intensiteti i aktiviteteve dhe mënyra e shfrytëzimit të hapësirës. Në territorin e Komunës së Suharekës, cilësia e ajrit ndikohet kryesisht nga trafiku rrugor, ngrohja individuale gjatë sezonit dimëror, aktivitetet ekonomike dhe lëvizja e mjeteve të rënda përgjatë akseve kryesore rrugore. Ndotja është më e theksuar në zonën urbane të Suharekës dhe përgjatë rrugëve kryesore, ndërsa në zonat rurale, kodrinore dhe pyjore niveli i ndotjes është më i ulët. Sa i përket ujërave sipërfaqësore, Komuna e Suharekës ka rrjet hidrografik të përfaqësuar nga lumi Toplluha dhe degët e tij, përroska lokale dhe rrjedha sezonale. Gjendja e ujërave sipërfaqësore ndikohet nga shkarkimet urbane, aktivitetet bujqësore, rrjedhjet sipërfaqësore gjatë reshjeve dhe erozioni. Në periudhat me reshje intensive mund të paraqitet bartje e materialeve të imëta në rrjedhat ujore, ndërsa gjatë periudhave të thata disa përroska kanë prurje të ulët ose karakter sezonal. Nga aspekti i tokës, Komuna e Suharekës karakterizohet me përbërje të ndryshme pedologjike. Në zonat fushore dhe përgjatë luginave paraqiten toka më produktive, të përshtatshme për bujqësi, ndërsa në zonat kodrinore dhe malore dominojnë toka më të cekëta, skeletore dhe me pjellori më të kufizuar. Në disa pjesë të komunës toka është e ndikuar nga erozioni, shfrytëzimi bujqësor, ndërtimet dhe aktivitetet ekonomike. Biodiversiteti në Komunën e Suharekës është i lidhur me sipërfaqet pyjore, kullosat, tokat bujqësore, rrjedhat ujore dhe zonat kodrinore e malore. Pyjet paraqesin resurs të rëndësishëm natyror dhe ekologjik, duke krijuar kushte për zhvillimin e florës dhe faunës lokale. Në këto zona mund të hasen shpendë, gjitarë të vegjël, zvarranikë dhe lloje të tjera karakteristike për mjediset rurale, pyjore dhe kodrinore të Kosovës. Ndotja akustike në Komunën e Suharekës është më e theksuar në zonat urbane, përgjatë rrugëve kryesore dhe në afërsi të aktiviteteve ekonomike. Në zonat rurale, bujqësore dhe pyjore niveli i zhurmës është më i ulët dhe lidhet kryesisht me qarkullimin lokal, aktivitetet bujqësore dhe veprimtaritë e kufizuara ekonomike. Gjendja aktuale e faktorëve mjedisorë në Komunën e Suharekës paraqet një mjedis me vlera natyrore, bujqësore dhe pyjore, por edhe me presione të caktuara nga zhvillimi urban, infrastruktura, bujqësia dhe aktivitetet ekonomike. Për këtë arsye, çdo zhvillim i ri duhet të planifikohet duke marrë parasysh mbrojtjen e ajrit, ujërave, tokës, biodiversitetit, peizazhit dhe cilësisë së jetës së popullsisë



## **5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT**

### **5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme**

Në kuadër të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, janë shqyrtuar këto alternativa të realizueshme, duke u bazuar në formatin dhe përmbajtjen e kërkuar për këtë kapitull.

**A. Ndërtimi dhe funksionalizimi i impiantit në lokacionin e propozuar** - Kjo alternativë parasheh ndërtimin dhe vendosjen e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror në lokacionin e planifikuar në Bllacë, Komuna e Suharekës. Aktiviteti përfshin pranimin e gurit gëlqeror, thërrmimin, sitjen, separimin dhe klasifikimin e materialit sipas fraksioneve të nevojshme. Materiali që do të përpunohet në impiant do të sigurohet nga projekti i planifikuar i eksplotimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani. Kjo alternativë mundëson organizim funksional të aktivitetit dhe përpunim të materialit në afërsi të zonës së eksplotimit.

**B. Mosrealizimi i projektit** - Kjo alternativë nënkupton që impianti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror të mos ndërtohet dhe të mos funksionalizohet. Në këtë rast nuk do të ketë ndikime të reja mjedisore nga ndërtimi, instalimi i pajisjeve, thërrmimi, separimi, pluhuri, zhurma apo lëvizja e kamionëve. Megjithatë, kjo alternativë do të pamundësonte përpunimin e gurit gëlqeror nga kompania dhe do të kufizonte shfrytëzimin ekonomik të materialit të nxjerrë nga zona e eksplotimit.

**C. Zhvendosja e impiantit në një lokacion tjetër** - Kjo alternativë do të kërkonte identifikimin e një lokacioni të ri, procedura të reja të lejeve, investime shtesë dhe ndërtim të infrastrukturës së re për qasje, energji, hapësira operative dhe organizim të procesit teknologjik. Gjithashtu, zhvendosja e impiantit në një lokacion tjetër do të mund të krijonte ndikime të reja mjedisore në një territor tjetër dhe do të rriste distancën e transportit të materialit nga zona e eksplotimit deri te impianti.

Pas analizës së alternativave, alternativa A konsiderohet më e favorshme, pasi mundëson ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit në lokacionin e propozuar, ka lidhje funksionale me projektin e planifikuar të eksplotimit të gurit gëlqeror dhe siguron zhvillimin e aktivitetit me ndikime të menaxhueshme mjedisore.

## **5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban dhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar**

Për këto arsye, alternativa e propozuar paraqet zgjidhjen më të përshtatshme për realizimin e projektit, pasi është teknologjikisht e zbatueshme, ekonomikisht më e arsyeshme dhe mjedisorisht më e menaxhueshme në krahasim me alternativat e tjera të shqyrtuara. Alternativa e propozuar, që parasheh ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, vlerësohet si më e përshtatshme, sepse siguron balancë ndërmjet realizueshmërisë teknike, ndikimit të kontrolluar mjedisor dhe qëndrueshmërisë ekonomike. Lokacioni ndërlidhet funksionalisht me projektin e planifikuar të eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani, prej nga do të sigurohet lënda e parë për përpunim. Kjo mundëson organizim më efikas të transportit, pranimi, thërmimit, seperimit dhe deponimit të përkohshëm të fraksioneve të gatshme. Gjithashtu, përzgjedhja e këtij lokacioni zvogëlon nevojën për transport të gjatë të materialit dhe krijon kushte më të përshtatshme për kontrollin e pluhurit, zhurmës, qarkullimit të mjeteve dhe menaxhimit të hapësirës operative. Kjo alternativë paraqet zgjidhjen më të qëndrueshme, me ndikime të menaxhueshme në tokë, ajër, zhurmë, trafik dhe peizazh, me kusht që të zbatohen masat e përcaktuara në këtë raport.

## **5.3. Vendndodhja ose rruga**

Vendndodhja e projektit në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, vlerësohet si e përshtatshme për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Qasja në lokacion do të realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor, ndërsa brenda hapësirës së projektit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullimin e kamionëve, ngarkuesve dhe makinerive të tjera. Rruga e transportit do të përdoret për sjelljen e materialit gëlqeror në impiant dhe për largimin e produktit final drejt tregut apo destinacioneve të përdorimit.

## **5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut**

Duke pasur parasysh se lokacioni i projektit për impiantin e thërmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ndodhet në distancë më të madhe se 1 km nga objektet më të afërta të banimit, nuk pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin e banimit. Kjo distancë krijon ndarje të mjaftueshme hapësinore ndërmjet aktivitetit të planifikuar të impiantit dhe vendbanimeve përreth, prandaj ndikimet e mundshme nga pluhuri, zhurma, lëvizja e mjeteve transportuese dhe funksionimi i pajisjeve konsiderohen të kufizuara

dhe të menaxhueshme, me kusht që të zbatohen masat e parapara për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.

### **5.5.Proceset dhe teknologjia e prodhimit**

Në kuadër të projektit për impiantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror do të zhvillohet proces mekanik i përpunimit të materialit. Prosesi teknologjik përfshin pranimin e gurit gëlqeror të nxjerrë nga zona e shfrytëzimit, furnizimin e impiantit me material, thërrmimin, sitjen, ndarjen granulometrike dhe depozitimin e fraksioneve të gatshme.

Materiali fillimisht transportohet deri te impianti me mjete transportuese dhe shkarkohet në zonën e pranimit. Më pas, përmes pajisjeve furnizuese, materiali dërgohet në njësinë e thërrmimit, ku zvogëlohet në përmasa më të vogla. Pas thërrmimit, materiali kalon në sistemin e sitjes dhe separimit, ku ndahet sipas madhësisë së kokrrizave në fraksione të ndryshme, të përshtatshme për përdorim në ndërtimtari dhe aktivitete të ngjashme.

Fraksionet e përfituara depozitohen në hapësira të veçanta brenda lokacionit të impiantit, ndërsa materiali që nuk arrin madhësinë e kërkuar mund të rikthehet përsëri në proces për thërrmim të mëtejshëm. Prosesi është kryesisht fizik dhe mekanik, pa përdorim të substancave kimike dhe pa trajtim industrial që mund të ndryshojë përbërjen kimike të gurit gëlqeror.

Gjatë funksionimit të impiantit pritet të krijohen kryesisht pluhur, zhurmë dhe vibrime lokale nga puna e pajisjeve mekanike dhe lëvizja e mjeteve transportuese. Për këtë arsye, do të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit përmes spërkatjes me ujë, mirëmbajtjes së pajisjeve, organizimit të qarkullimit të mjeteve dhe menaxhimit të materialit të depozituar. Uji do të përdoret vetëm për spërkatje dhe nuk do të jetë pjesë e procesit teknologjik të prodhimit.

### **5.6.Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit**

Aktiviteti i impiantit të thërrmimit dhe separimit do të realizohet në mënyrë të organizuar, duke filluar me përgatitjen e lokacionit, instalimin e pajisjeve dhe funksionalizimin e linjës teknologjike. Gjatë funksionimit, materiali gëlqeror do të pranohet në impiant, do të futet në thërrmues, do të bartet me shirita transportues, do të kalojë nëpër sita dhe do të ndahet në fraksione të ndryshme. Operacionet do të kryhen nga personel i trajnuar dhe i pajisur me mjete mbrojtëse personale. Pajisjet dhe makineritë do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt teknike, me qëllim funksionimin e sigurt dhe uljen e rrezikut për aksidente apo ndotje. Gjatë funksionimit do të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, qarkullimit të mjeteve dhe menaxhimit të ujërave atmosferike. Nuk parashihet përdorim i ujit për proces teknologjik të largës së materialit dhe nuk gjenerohen ujëra industriale.

### **5.7. Plani i lokacionit**

Plani i lokacionit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror përfshin organizimin funksional të hapësirës operative, në përputhje me nevojat teknike të procesit të përpunimit. Në plan parashihen:

- Hapësira për pranimin dhe shkarkimin e gurit gëlqeror;
- Zona për vendosjen e thërrmuesit dhe pajisjeve kryesore;
- Zona për vendosjen e sitave dhe shiritave transportues;
- Hapësirat për deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gatshme;
- Rrugët e brendshme për qarkullimin e kamionëve dhe makinerive;
- Hapësirat për manovrim, ngarkim dhe parkim të përkohshëm të pajisjeve.



*Figura 5. Plani i vendosjen se imipantit*

Plani parasheh organizim të qartë të qarkullimit brenda lokacionit, duke siguruar hyrje dhe dalje të kontrolluar të mjeteve transportuese, si dhe ndarje funksionale të zonave të punës.

### **5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit**

Për realizimin e projektit parashihet përdorimi i pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit. Këto përfshijnë thërrmuesin, sitat vibruese, shiritat transportues, bunkerët, strukturat mbajtëse, pajisjet ndihmëse dhe makineritë për ngarkim e transport. Materiali kryesor që do të përpunohet është guri gëlqeror, i cili do të sigurohet nga projekti i planifikuar i eksploatimit të kompanisë. Si burim energjie mund të përdoret energjia elektrike për pajisjet e impiantit, ndërsa makineritë ndihmëse dhe mjetet transportuese mund të funksionojnë me karburant dizel. Për kontrollin e pluhurit mund të përdoret ujë për spërkatje të sipërfaqeve operative dhe rrugëve të brendshme.

## **5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit**

Projekti për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror është në fazë planifikimi dhe impianti ende nuk është i ndërtuar. Punët përgatitore, ndërtimi i bazës operative dhe instalimi i pajisjeve do të fillojnë pas pajisjes me pëlqimin mjedisor dhe lejet e tjera të nevojshme. Faza e ndërtimit dhe montimit pritet të realizohet brenda një periudhe të kufizuar kohore, varësisht nga kushtet në terren, furnizimi me pajisje dhe dinamika e organizimit të punës. Pas përfundimit të instalimit, impianti do të testohet dhe më pas do të fillojë funksionimin e rregullt. Afati i operimit është i lidhur me jetëgjatësinë teknike të pajisjeve, vlefshmërinë e lejeve, kërkesën e tregut dhe furnizimin me material nga zona e eksploatimit. Pas përfundimit të funksionimit, lokacioni do të pastrohet, pajisjet do të largohen dhe sipërfaqja do të rehabilitohet sipas kërkesave ligjore.

### **5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit**

Impianti I thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror shtrihet në një sipërfaqe prej **34590.9 m<sup>2</sup>**. Kjo sipërfaqe përfshin bunke, rrugët e brendshme dhe hapësirat për qarkullim, zona e pranimit dhe shkarkimit të materialit, zona e thërrmimit, sitjes dhe separimit, zona e depozitimit të fraksioneve, dhe organizim të operimit, në përputhje me planin minerar të miratuar.

### **5.11. Vëllimi i prodhimit**

Vëllimi i prodhimit në kuadër të impiantit të thërrmimit dhe separimit do të përcaktohet në përputhje me kapacitetin teknik të pajisjeve, organizimin e punës, numrin e ditëve të operimit gjatë vitit, furnizimin me material gëlqeror dhe kërkesën e tregut. Kapacitet i projektuar është parapare të jete 300 m<sup>3</sup>/ore.

### **5.12. Kontrolli i ndotjes**

Për projektin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit janë parashikuar masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, emetimeve nga makineritë dhe ndikimeve të tjera mjedisore. Kontrolli i pluhurit do të realizohet përmes spërkatjes së rrugëve të brendshme dhe sipërfaqeve operative gjatë periudhave të thata, mirëmbajtjes së hapësirave të punës dhe organizimit të rregullt të deponimit të materialit. Zhurma do të menaxhohet përmes përdorimit të pajisjeve në gjendje të mirë teknike, mirëmbajtjes së rregullt dhe respektimit të orarit të punës. Makineritë dhe mjetet transportuese do të mirëmbahen rregullisht për të reduktuar emetimet nga motorët me naftë dhe për të parandaluar rrjedhjet e mundshme të karburantit apo vajrave.

**5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar**

Në kuadër të impiantit të thërrmimit dhe seperimit nuk parashihet krijim i mbeturinave industriale të rrezikshme nga procesi teknologjik, pasi aktiviteti përfshin vetëm përpunim mekanik të gurit gëlqeror. Mbeturinat komunale nga personeli do të grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe do të largohen nga kompania e kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave.

**5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit**

Qasja në lokacionin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit në lokalitetin Bllacë do të realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor, i cili mundëson hyrje dhe dalje të organizuar të mjeteve transportuese. Brenda lokacionit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullimin e kamionëve, ngarkuesve dhe makinerive, si dhe hapësira për manovrim, shkarkim, ngarkim dhe parkim të përkohshëm. Projekti nuk kërkon ndërhyrje të mëdha infrastrukturore jashtë perimetrit të zonës së projektit, pasi do të shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese rrugore dhe do të bëhet organizimi i qasjes në funksion të nevojave operative të impiantit.

**5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit**

Kompania “StoneX Holding” SH.P.K. është përgjegjëse për respektimin e të gjitha kërkesave mjedisore gjatë ndërtimit, instalimit dhe funksionimit të impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Përgjegjësia përfshin zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e pajisjeve, parandalimin e rrjedhjeve të karburantit apo vajrave dhe menaxhimin e ujërave atmosferike. Kompania është e obliguar të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, të raportojë sipas kërkesave ligjore dhe të sigurojë që aktiviteti të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe kërkesat teknike të operimit.

**5.16. Trajnimi**

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

**5.17. Monitorimi**

Monitorimi i parametrave mjedisore do të realizohet periodikisht, sipas kërkesave ligjore.

**5.18. Planet për situata emergjente**

Për projektin e propozuar duhet të parashihen plane të qarta për menaxhimin e situatave emergjente, me qëllim mbrojtjen e punëtorëve, popullsisë përreth, pronës dhe mjedisit. Situatat emergjente mund të paraqiten si rezultat i aksidenteve gjatë punës, prishjeve teknike të

makinerive, rrjedhjeve të karburanteve dhe vajrave, zjarreve, lëndimeve të punëtorëve, kushteve të pafavorshme atmosferike, rrëshqitjeve të dheut apo rasteve të tjera të paparashikuara.

#### **5.19. Demolimi dhe rehabilitimi**

Pas përfundimit të aktivitetit të impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, nëse operatori vendos ta ndërpresë veprimtarinë, do të bëhet çmontimi i pajisjeve dhe rehabilitimi i sipërfaqes së shfrytëzuar. Meqenëse impianti ka karakter mekanik dhe përbëhet kryesisht nga pajisje të lëvizshme ose gjysmë të lëvizshme, demolimi nuk pritet të jetë kompleks.

Në fazën e demolimit do të bëhet largimi i pajisjeve të thërrmimit, sitjes dhe separimit, çmontimi i strukturave ndihmëse, largimi i materialeve të mbetura dhe pastrimi i përgjithshëm i lokacionit. Të gjitha pjesët metalike, pajisjet teknike dhe materialet tjera që mund të ripërdoren apo riciklohen do të trajtohen në mënyrë të kontrolluar dhe do të dërgohen te operatorët e licencuar.

Gjatë largimit të pajisjeve duhet të sigurohet që të mos ketë derdhje të vajrave, karburanteve apo substancave të tjera ndotëse në tokë. Nëse gjatë çmontimit vërehen zona të ndotura, ato duhet të pastrohen menjëherë dhe materiali i kontaminuar të trajtohet sipas kërkesave ligjore për menaxhimin e mbeturinave.

Pas largimit të impiantit, sipërfaqja do të rehabilitohet duke u niveluar dhe pastruar nga mbetjet e materialit guror, mbeturinat ndërtimore apo elementet tjera të panevojshme. Në varësi të gjendjes së terrenit, mund të bëhet mbushja e gropave, rregullimi i pjerrësive dhe, aty ku është e mundur, mbulimi me shtresë dheu dhe gjelbërimi i sipërfaqes.

Rehabilitimi do të ketë për qëllim kthimin e lokacionit në gjendje të qëndrueshme dhe të sigurt për mjedisin, duke zvogëluar rrezikun nga erozioni, shpërndarja e pluhurit dhe ndikimet vizuale në peizazh. Pas përfundimit të këtyre punëve, lokacioni duhet të lihet i pastër, i stabilizuar dhe pa materiale apo pajisje që mund të paraqesin rrezik për tokën, ujin, ajrin apo sigurinë e njerëzve.

#### **5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit**

Plani për menaxhimin e mjedisit përcakton masat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të aktivitetit, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të mundshme në mjedis. Operatorit i kërkohet që punimet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lejuar të projektit dhe në përputhje me kushtet teknike dhe ligjore.

Gjatë operimit duhet të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve, mbeturinave, ujërave atmosferike dhe mbrojtjen e tokës nga ndotja. Makineritë duhet të

mirëmbahen rregullisht, ndërsa çdo rrjedhje e vajrave apo karburanteve duhet të pastrohet menjëherë. Mbeturinat duhet të grumbullohen, ndahen dhe dorëzohen te operatorët e autorizuar.

#### **5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim**

Alternativa pa veprim nënkupton mosrealizimin e projektit për impiantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror. Në këtë rast, lokacioni do të mbetet në gjendjen ekzistuese dhe nuk do të vendoseshin pajisjet e impiantit.

Nga aspekti mjedisor, kjo alternativë do të shmangte ndikimet e mundshme nga pluhuri, zhurma, lëvizja e mjeteve transportuese dhe depozitimi i materialit. Gjithashtu, nuk do të kishte nevojë për përdorim të ujit për spërkatje apo për organizim të sipërfaqes së punës.

Megjithatë, mosrealizimi i projektit do të pamundësonte shfrytëzimin e materialit guror dhe prodhimin e fraksioneve të gurit gëlqeror për nevoja të ndërtimtarisë. Kjo do të kufizonte aktivitetin ekonomik të operatorit dhe përfitimet që lidhen me furnizimin e tregut dhe punësimin.

Duke marrë parasysh se projekti ka kapacitet të ulët dhe mund të menaxhohet me masa të përshtatshme mbrojtëse, realizimi i tij konsiderohet i pranueshëm, me kusht që të zbatohen masat për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe mbrojtjen e mjedisit.



## **6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS**

### **6.1 Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë**

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e ndikimeve që mund të shkaktojë projekti për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Vlerësimi është bazuar në natyrën e projektit, dokumentacionin teknik, karakteristikat e lokacionit dhe gjendjen ekzistuese mjedisore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndikimet janë analizuar në tre aspekte kryesore:

- **Aspektet fizike**, që përfshijnë ndikimet në cilësinë e ajrit nga pluhuri gjatë shkarkimit, thërrmimit, sitjes, seperimit, deponimit të materialit dhe lëvizjes së kamionëve, zhurmën nga pajisjet dhe makineritë, si dhe ndikimet në tokë, ujëra atmosferike dhe peizazh;
- **Aspektet biologjike**, që lidhen me ndikimet e mundshme në vegjetacionin dhe mjedisin përreth lokacionit ku planifikohet të vendoset impianti;
- **Aspektet socio-ekonomike**, që përfshijnë ndikimin në komunitetin lokal, punësimin, qarkullimin rrugor dhe zhvillimin ekonomik të kompanisë.

Duke qenë se projekti përfshin përpunim mekanik të gurit gëlqeror, pa trajtim kimik, pa djegie dhe pa përdorim të ujit për larje industriale, ndikimet mjedisore vlerësohen si lokale dhe të menaxhueshme. Ndikimet kryesore lidhen me pluhurin, zhurmën, lëvizjen e mjeteve transportuese dhe organizimin e hapësirës operative. Këto ndikime do të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative të parapara në këtë raport. Qëllimi i vlerësimit është që ndërtimi dhe funksionimi i impiantit të realizohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kërkesat ligjore dhe duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### **6.2. Cilësinë e ajrit**

Cilësia e ajrit në zonën e projektit mund të ndikohet përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, instalimit të pajisjeve dhe funksionimit të impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Burimi kryesor i ndikimit në ajër do të jetë pluhuri që mund të krijohet gjatë shkarkimit të materialit gëlqeror, futjes së tij në thërrmues, thërrmimit, sitjes, seperimit, bartjes me shirita transportues, deponimit të fraksioneve dhe qarkullimit të kamionëve në rrugët e brendshme të lokacionit. Një ndikim shtesë në cilësinë e ajrit mund të vijë edhe nga gazrat e djegies që lirohen nga makineritë dhe mjetet transportuese që përdorin karburant dizel. Këto emetime janë të lidhura kryesisht me ngarkuesit, kamionët dhe pajisjet ndihmëse gjatë operimit të impiantit. Megjithatë, duke qenë se lokacioni ndodhet në distancë më të madhe se 1 km nga

objektet më të afërta të banimit, nuk pritet ndikim i drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit të zonave të banuara. Ndikimi në ajër vlerësohet kryesisht lokal, i kufizuar brenda dhe përreth zonës operative të impiantit, dhe i menaxhueshëm përmes masave si spërkatja me ujë, mirëmbajtja e rrugëve të brendshme, kufizimi i shpejtësisë së mjeteve dhe mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve.

### **6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi**

Substancat kryesore ndotëse që mund të paraqiten në ajër gjatë funksionimit të impiantit janë pluhuri total dhe grimcat e imëta të pluhurit, të cilat krijohen gjatë thërmimit, sitjes, seperimit, bartjes dhe deponimit të materialit gëlqeror. Përveç pluhurit, mund të paraqiten edhe emetime nga djegia e karburantit në makineri dhe kamionë, kryesisht CO<sub>2</sub>, CO dhe oksidet e azotit NO<sub>x</sub>. Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit, i cili përfshin vetëm përpunim mekanik të gurit gëlqeror dhe nuk përfshin procese kimike, djegie industriale apo trajtim me substanca të rrezikshme, nuk priten përqendrime të larta dhe të vazhdueshme të ndotësve në ajër jashtë perimetrit të lokacionit. Përqendrimet më të theksuara të pluhurit pritet të jenë në afërsi të thërmuesit, sitave, shiritave transportues, zonave të deponimit dhe rrugëve të brendshme të qarkullimit. Në zonat përreth, përqendrimet e ndotësve pritet të ulen ndjeshëm si rezultat i shpërndarjes natyrore në hapësirë dhe distancës nga receptorët e ndjeshëm. Duke qenë se shtëpitë e banimit ndodhen më larg se 1 km nga lokacioni i projektit, ndikimi në popullsinë përreth konsiderohet i kufizuar.

### **6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike**

Projekti për impiantin e thërmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nuk paraqet burim të rëndësishëm të emetimeve të gazeve serrë, pasi nuk përfshin proces të djegies industriale, nuk përdor lëndë djegëse për prodhim termik dhe nuk zhvillon procese kimike. Emetimet e gazeve serrë lidhen kryesisht me përdorimin e karburantit nga kamionët, ngarkuesit dhe makineritë ndihmëse që do të përdoren për transport, shkarkim, ngarkim dhe manipulim të materialit. Nëse pajisjet e impiantit funksionojnë me energji elektrike, ndikimi i drejtpërdrejtë në emetimet e gazeve serrë do të jetë më i ulët. Në rast të përdorimit të gjeneratorëve apo pajisjeve me karburant, emetimet do të varen nga intensiteti i operimit, gjendja teknike e pajisjeve dhe kohëzgjatja e punës. Për shkak të karakterit lokal të projektit dhe natyrës mekanike të procesit, vëllimi i emetimeve konsiderohet relativisht i kufizuar. Sa i përket ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, projekti mund të ndikohet nga periudhat e thata dhe temperaturat e larta, të cilat mund të rrisin krijimin dhe përhapjen e pluhurit gjatë thërmimit, deponimit dhe

qarkullimit të mjeteve. Po ashtu, reshjet intensive mund të ndikojnë në qarkullimin brenda lokacionit dhe në menaxhimin e ujërave atmosferike, sidomos nëse sipërfaqet operative nuk janë të organizuara si duhet. Megjithatë, projekti ka mundësi të menaxhojë këto ndikime përmes masave teknike dhe organizative, si spërkatja me ujë gjatë periudhave të thata, mirëmbajtja e rrugëve të brendshme.

#### **6.5.Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit**

Bazuar në natyrën, madhësinë dhe shtrirjen e kufizuar të projektit, nuk pritet që aktiviteti të shkaktojë ndotje ndërkufitare të ajrit. Emetimet në ajër nga projekti janë të karakterit lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin dhe gazrat nga makineritë dhe kamionët brenda perimetrit të zonës së eksploatimit. Këto ndikime shpërndahen në distancë të shkurtër dhe nuk kanë potencial për përhapje në shkallë rajonale apo ndërkufitare. Për këtë arsye, projekti nuk konsiderohet burim i ndotjes ndërkufitare të ajrit.

#### **6.6.Cilësia e ujit**

Në kuadër të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga “StoneX Holding” SH.P.K., cilësia e ujit nuk pritet të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi teknologjik, pasi aktiviteti përfshin vetëm përpunim mekanik të materialit, përkatësisht thërrmim, sitje dhe separim. Projekti nuk parasheh larje industriale të gurit gëlqeror dhe nuk gjeneron ujëra teknologjike apo industriale. Rrezik i mundshëm paraqitet vetëm në raste aksidentale, si rrjedhje të karburanteve apo vajrave nga makineritë dhe mjetet transportuese. Me organizim të mirë të lokacionit, mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve, kontroll të rrjedhjeve aksidentale dhe menaxhim të ujërave atmosferike, ndikimi në cilësinë e ujit vlerësohet i ulët dhe i menaxhueshëm.

#### **6.7.Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore**

Bazuar në natyrën e projektit, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, pasi impianti nuk parasheh shkarkime të ujërave të ndotura nga procesi teknologjik. Procesi i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror zhvillohet në mënyrë mekanike dhe nuk kërkon përdorim të ujit për larje apo trajtim të materialit. Ndotësit potencialë që mund të ndikojnë në ujë lidhen kryesisht me situata të paparashikuara, si rrjedhje të naftës, vajrave lubrifikues apo lëndëve të tjera nga makineritë dhe kamionët. Po ashtu, gjatë reshjeve atmosferike mund të ketë bartje të materialit të imët nga sipërfaqet operative, nëse nuk sigurohet kullim i ujërave. Këto ndikime do të jenë lokale dhe të kufizuara. Mundësia për ndikim në ujërat nëntokësore mbetet e ulët, nëse zbatohen masat për mirëmbajtjen teknike të pajisjeve, parkimin e kontrolluar të makinerive, ndalimin e derdhjeve të karburanteve në tokë

dhe reagimin e menjëhershëm në rast aksidenti. Për këtë arsye, ndikimi i projektit në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet si i ulët dhe i menaxhueshëm.

#### **6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkuftare të ujërave**

Duke marrë parasysh shkallën e projektit, natyrën lokale të aktivitetit dhe mungesën e shkarkimeve ujore nga procesi teknologjik, nuk pritet që impianti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror të ketë ndikim në ndotjen ndërkuftare të ujërave. Ujërat atmosferike që mund të krijohen në lokacion do të menaxhohen brenda hapësirës së projektit, përmes organizimit të sipërfaqeve operative dhe masave për ndalimin e bartjes së materialit të imët jashtë lokacionit. Për këtë arsye, projekti nuk konsiderohet burim i ndotjes ndërkuftare të ujërave.

#### **6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza**

Projekti për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nuk parashihet të shkaktojë ndryshime hidromorfologjike të trupave ujorë, pasi nuk përfshin ndërhyrje në shtretër lumenjsh, përroje, kanale apo trupa të tjerë ujorë. Aktiviteti zhvillohet në një lokacion tokësor dhe lidhet me vendosjen e pajisjeve mekanike, pranimin e materialit, thërrmimin, sitjen, seperimin dhe deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gatshme. Projekti nuk parasheh përdorim të ujit në proces teknologjik për larje të materialit dhe nuk gjeneron ujëra industriale. Për këtë arsye, nuk parashihen shkarkime të ujërave të zeza teknologjike nga impianti.

Sa i përket ujërave sanitare, ato mund të krijohen vetëm nga personeli i angazhuar në lokacion. Duke qenë se nuk parashihet ndërtimi i kampeve apo rezidencave për punëtorë, ndikimi nga ujërat sanitare mbetet minimal dhe i menaxhueshëm përmes organizimit të përshtatshëm sanitar, sipas kushteve të operimit. Për rrjedhojë, nuk priten ndryshime të rëndësishme në sasinë apo cilësinë e ujërave si rezultat i funksionimit të projektit.

#### **6.10. Toka**

Ndikimet e projektit në tokë lidhen kryesisht me ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Meqenëse impianti nuk është ende i ndërtuar, ndikimet në tokë do të paraqiten gjatë fazës së përgatitjes së lokacionit, nivelimit të terrenit, vendosjes së pajisjeve teknologjike, krijimit të rrugëve të brendshme operative dhe hapësirave për deponimin e përkohshëm të materialit. Gjatë funksionimit, ndikimet në tokë mund të lidhen me depozitimin e pluhurit mineral, qarkullimin e kamionëve dhe makinerive, si dhe me mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të karburanteve apo vajrave nga pajisjet. Megjithatë, këto ndikime pritet të jenë të kufizuara brenda lokacionit të projektit dhe të menaxhueshme përmes

organizimit të mirë të hapësirës operative, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe zbatimit të masave parandaluese.

#### **6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës**

Gjatë ndërtimit dhe përgatitjes së lokacionit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit mund të ketë ndryshime të kufizuara fizike në sipërfaqen e tokës, kryesisht për shkak të nivelimit të terrenit, përgatitjes së bazamentit për vendosjen e pajisjeve dhe organizimit të hapësirave për qarkullim, shkarkim, ngarkim dhe deponim të përkohshëm të fraksioneve. Ndryshe nga aktiviteti i eksploatimit, ky projekt nuk përfshin minime, largim të masës shkëmbore nga vendburimi apo krijim të fronteve minerare. Për këtë arsye, ndryshimet në topografinë lokale pritet të jenë më të kufizuara dhe të lidhen vetëm me rregullimin e lokacionit për nevoja operative të impiantit. Erozioni i tokës mund të paraqitet nëse sipërfaqet e hapura nuk menaxhohen si duhet, sidomos gjatë reshjeve intensive. Rreziku për rrëshqitje të tokës vlerësohet i ulët, me kusht që terreni të organizohet në mënyrë të qëndrueshme dhe ujërat atmosferike të drejtohen e menaxhohen në mënyrë të kontrolluar. Me zbatimin e masave për kullim, mirëmbajtje të rrugëve të brendshme dhe stabilizim të sipërfaqeve operative, këto ndikime mbeten të menaxhueshme.

#### **6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës**

Ndikimet e mundshme në tokë nga emetimet ndotëse lidhen kryesisht me depozitimin e pluhurit mineral që krijohet gjatë shkarkimit, thërrmimit, sitjes, seperimit, bartjes me shirita transportues, deponimit të fraksioneve dhe qarkullimit të kamionëve në lokacion. Ky pluhur ka natyrë minerale dhe buron nga përpunimi mekanik i gurit gëlqeror. Depozitimi i pluhurit mund të ndikojë në sipërfaqet brenda lokacionit dhe në zonën e afërt përreth, por për shkak të karakterit lokal të aktivitetit dhe mungesës së proceseve kimike apo industriale me substanca të rrezikshme, ndikimi pritet të jetë i kufizuar. Rrezik tjetër i mundshëm për tokën lidhet me rrjedhjet aksidentale të karburanteve, vajrave apo lubrifikantëve nga makineritë dhe mjetet transportuese. Nëse pajisjet mirëmbahen rregullisht, parkimi bëhet në vende të kontrolluara dhe ndërhyhet menjëherë në rast rrjedhjeje, ndikimi në cilësinë e tokës vlerësohet i ulët dhe brenda niveleve të menaxhueshme sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

### **6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore**

Projekti ndikon në mënyrën e shfrytëzimit të tokës, pasi sipërfaqja e përzgjedhur do të përdoret për vendosjen dhe funksionimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Kjo përfshin hapësirat për pajisjet teknologjike, pranimin e lëndës së parë, deponimin e përkohshëm të fraksioneve, qarkullimin e kamionëve dhe aktivitetet ndihmëse operative. Burimi natyror që lidhet drejtpërdrejt me këtë projekt është guri gëlqeror, i cili do të shërbejë si lëndë e parë për përpunim mekanik. Ky material do të sigurohet nga projekti i planifikuar i eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani. Në vetë lokacionin e impiantit nuk parashihet nxjerrje e resurseve minerare, por vetëm pranimi, thërrmimi, separimi dhe klasifikimi i materialit. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës mbetet i kufizuar brenda lokacionit të paraparë për impiantin dhe mund të menaxhohet përmes organizimit racional të hapësirës, kufizimit të zonave të punës dhe rehabilitimit të lokacionit pas përfundimit të funksionimit.

### **6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur**

Bazuar në karakterin e projektit, ndërtimi dhe funksionalizimi i impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nuk pritet të shkaktojë humbje të konsiderueshme të tokës bujqësore me vlerë të lartë prodhuese. Në kuadër të ngastrave të projektit paraqiten toka që janë të klasës së V dhe VII, ndërsa disa pjesë janë të evidentuara si tokë pyjore. Gjatë përgatitjes së lokacionit mund të ketë largim të kufizuar të shtresës sipërfaqësore të tokës në hapësirat ku do të vendosen pajisjet, rrugët e brendshme dhe zonat për deponimin e përkohshëm të materialit. Nëse në lokacion paraqitet shtresë humusore, ajo duhet të largohet me kujdes, të deponohet veçmas dhe të ruhet për t'u përdorur gjatë rehabilitimit të sipërfaqeve pas përfundimit të aktivitetit.

### **6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike**

Projekti për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nuk pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë të rëndësishëm në karakteristikat gjeologjike të lokacionit, pasi nuk përfshin minime, gjurmime të thella apo largim të masës shkëmbore nga vendburimi. Aktiviteti kryesor i projektit është përpunimi mekanik i gurit gëlqeror që do të sillet nga zona e planifikuar e eksploatimit. Ndikimi në karakteristikat gjeomorfologjike lidhet kryesisht me përgatitjen dhe rregullimin e sipërfaqes për vendosjen e impiantit, rrugëve të brendshme dhe hapësirave të deponimit të përkohshëm. Këto ndërhyrje mund të shkaktojnë ndryshime të kufizuara në pamjen dhe konfiguracionin lokal të terrenit, por nuk ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme strukturën gjeologjike të zonës. Me organizim të mirë të lokacionit, kufizim të ndërhyrjeve vetëm brenda hapësirës së projektit dhe rehabilitim pas përfundimit të funksionimit, ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike vlerësohet i ulët dhe i menaxhueshëm.

#### **6.16. Popullsia lokale**

Lokacioni i projektit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndodhet jashtë zonës së drejtpërdrejtë të banimit. Shtëpitë më të afërta janë në distancë më të madhe se 1 km nga lokacioni i planifikuar i impiantit, prandaj ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë lokale vlerësohet i kufizuar. Ndikimet e mundshme mund të lidhen me pluhurin, zhurmën dhe qarkullimin e kamionëve, por këto do të jenë të menaxhueshme përmes masave mbrojtëse, mirëmbajtjes së pajisjeve, kontrollit të pluhurit dhe respektimit të orarit të punës.

#### **6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi**

Projekti nuk pritet të shkaktojë ndryshime në numrin, strukturën apo përqendrimin e popullsisë në zonën përreth. Ndërtimi dhe funksionimi i impiantit nuk kërkon zhvendosje të banorëve, nuk ndikon në migrim dhe nuk krijon presion të ri urbanistik. Punëtorët do të angazhohen në baza ditore dhe nuk parashihet ndërtim i kampeve apo vendbanimeve të përkohshme. Ndikimet në popullsi janë kryesisht të karakterit lokal dhe të kufizuar gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të impiantit.

#### **6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve**

Ndikimet vizuale nga projekti lidhen me vendosjen e pajisjeve të impiantit, hapësirat për deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gurit gëlqeror, qarkullimin e kamionëve dhe organizimin e hapësirës operative. Për shkak se lokacioni ndodhet në distancë më të madhe se 1 km nga objektet më të afërta të banimit, ndikimi vizual në vendbanimet përreth pritet të jetë i kufizuar. Organizimi i rregullt i lokacionit, ndarja e hapësirave të punës dhe rehabilitimi i sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit do të ndihmojnë në zvogëlimin e ndikimit vizual.

#### **6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut**

Gjatë funksionimit të impiantit mund të krijohen pluhur, gazra nga makineritë dhe mjetet transportuese që përdorin karburant dizel, si dhe zhurmë nga thërrmuesit, sitat vibruese, shiritat transportues, ngarkuesit dhe kamionët. Vibrimet mund të jenë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me funksionimin e pajisjeve mekanike të impiantit, por nuk priten vibrime të rëndësishme jashtë zonës operative. Nuk priten emetime të nxehtësisë apo rrezatim jonizues dhe jojonizues, pasi projekti nuk përfshin procese termike, kimike apo pajisje që gjenerojnë rrezatim. Ndikimi më i ndjeshëm mund të jetë për punëtorët në lokacion, të cilët duhet të përdorin pajisje mbrojtëse personale kundër pluhurit, zhurmës dhe rreziqeve mekanike. Për popullsinë përreth, ndikimi pritet të jetë i ulët për shkak të distancës më të madhe se 1 km nga shtëpitë e banimit.

#### **6.20. Ndikimet socio-ekonomike**

Projekti pritet të ketë ndikim pozitiv socio-ekonomik, pasi mundëson ndërtimin dhe funksionalizimin e një impianti për përpunimin mekanik të gurit gëlqeror, angazhimin e fuqisë punëtore dhe furnizimin e tregut me fraksione të ndryshme të materialit ndërtimor. Aktiviteti mund të ndikojë pozitivisht në të hyrat e kompanisë, në punësim dhe në zhvillimin e sektorit të ndërtimit. Ndikimet negative socio-ekonomike janë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me shqetësimet e mundshme nga trafiku, pluhuri dhe zhurma gjatë funksionimit të impiantit. Me zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit, mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe organizimin e qarkullimit të kamionëve, këto ndikime vlerësohen të menaxhueshme.

#### **6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës**

Impianti i thërmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ndërlidhet me sektorin minerar dhe ndërtimor, të cilët kanë rëndësi për ekonominë lokale dhe rajonale. Projekti kontribuon në përpunimin e materialit gëlqeror dhe në sigurimin e fraksioneve të gatshme për përdorim në ndërtimtari, infrastrukturë rrugore, beton, asfalt dhe qëllime të tjera teknike. Ndikimi në sektorët tjerë, si bujqësia dhe shërbimet, pritet të jetë i kufizuar, pasi projekti zhvillohet jashtë qendrave të banuara dhe nuk prek drejtpërdrejt veprimtari ekzistuese të rëndësishme. Përkundrazi, projekti mund të krijojë kërkesë shtesë për shërbime lokale, transport, mirëmbajtje dhe furnizime ndihmëse.

#### **6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura**

Projekti përfshin fazën e ndërtimit, montimit të pajisjeve dhe fazën e funksionimit të impiantit. Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit do të angazhohen punëtorë për përgatitjen e lokacionit, vendosjen e pajisjeve, montimin e linjës teknologjike dhe rregullimin e hapësirave operative. Gjatë funksionimit do të angazhohen punëtorë për pranimin e materialit, operimin e thërmuesit, sitave dhe shiritave transportues, ngarkimin e fraksioneve, transportin, mirëmbajtjen teknike, mbikëqyrjen e punës dhe sigurinë në lokacion. Nuk pritet humbje e vendeve të punës në sektorët tjerë, pasi projekti nuk zhvendos biznese, nuk prek vendbanime dhe nuk ndërpret veprimtari ekzistuese të rëndësishme në zonë.



### **6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare**

Projekti kontribuon në ekonominë rajonale dhe kombëtare përmes përpunimit të resurseve minerare vendore, furnizimit të tregut me fraksione të gurit gëlqeror, krijimit të vendeve të punës dhe pagesës së detyrimeve ligjore. Impianti do të ndihmojë në sigurimin e materialeve bazë për sektorin e ndërtimit, infrastrukturës rrugore, betonit dhe asfaltit. Gjithashtu, projekti ndihmon në rritjen e vlerës së materialit të nxjerrë nga zona e eksploatimit, pasi guri gëlqeror nuk do të mbetet vetëm si material i papërpunuar, por do të përpunohet dhe klasifikohet në fraksione të përdorshme për treg. Në këtë mënyrë, projekti paraqet një kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik lokal, rajonal dhe kombëtar.

### **6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia**

Zona e projektit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror ka karakter të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit të përpunimit mekanik të materialit gëlqeror. Aktiviteti kryesor lidhet me pranimin, thërrmimin, sitjen, separimin dhe deponimin e përkohshëm të materialit. Ndikimi në ekosisteme mund të lidhet me përgatitjen e sipërfaqes për vendosjen e impiantit, lëvizjen e makinerive, krijimin e pluhurit dhe zhurmës gjatë funksionimit. Këto ndikime pritet të jenë lokale dhe të kufizuara brenda lokacionit të projektit. Me organizim të mirë të hapësirës operative, kontroll të pluhurit dhe mirëmbajtje të pajisjeve, ndikimet në ekosisteme dhe në mjedisin përreth vlerësohen të menaxhueshme.

### **6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre**

Gjatë përgatitjes së lokacionit për vendosjen e impiantit mund të ketë largim të kufizuar të vegjetacionit ekzistues dhe shqetësim të përkohshëm të faunës lokale. Shqetësimi mund të vijë nga zhurma, pluhuri, lëvizja e kamionëve dhe funksionimi i pajisjeve mekanike të impiantit. Nuk janë identifikuar specie të mbrojtura apo habitate të veçanta brenda lokacionit të projektit. Ndikimi duhet të kufizohet duke mos dalë jashtë kufijve të lokacionit të paraparë, duke ruajtur hapësirat përreth dhe duke realizuar pastrimin dhe rehabilitimin e sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit.

### **6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe geomorfologjike biodiversitetit, florës dhe faunës, pjesë të natyrorë të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve për egra dhe habitateve të tyre**

Në lokacionin e projektit nuk janë identifikuar pasuri natyrore të mbrojtura, zona paleontologjike, specie të rralla apo të rrezikuara të regjistruara. Ndikimet e mundshme në

geomorfologji lidhen kryesisht me rregullimin e sipërfaqes për vendosjen e pajisjeve, rrugëve të brendshme dhe hapësirave për deponim të përkohshëm të fraksioneve. Ndikimet në florë dhe faunë pritet të jenë lokale dhe të kufizuara, kryesisht nga largimi i vegjetacionit të kufizuar, zhurma, pluhuri dhe lëvizja e mjeteve. Me zbatimin e masave mbrojtëse dhe rehabilitimin e lokacionit pas përfundimit të aktivitetit, këto ndikime vlerësohen të menaxhueshme.

#### **6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve**

Sipërfaqja e projektit do të shfrytëzohet për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Përdorimi kryesor i zonës lidhet me aktivitetin e përpunimit mekanik të materialit, përfshirë pranimin e lëndës së parë, thërrmimin, sitjen, separimin, klasifikimin dhe deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gatshme. Në kuadër të lokacionit do të organizohen hapësirat për vendosjen e pajisjeve teknologjike, rrugët e brendshme për qarkullimin e kamionëve dhe makinerive, hapësirat për shkarkim dhe ngarkim, si dhe zonat për deponimin e materialit. Pas përfundimit të funksionimit të impiantit, pajisjet do të largohen dhe sipërfaqja do të pastrohet e rehabilitohet, me qëllim kthimin e saj në gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme.

#### **6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara**

Projekti parasheh ndërtimin dhe vendosjen e një impianti të ri për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror. Aktualisht impianti nuk është i ndërtuar, ndërsa sipërfaqja e projektit do të organizohet për nevoja operative të procesit teknologjik. Sipërfaqet e ndërtuara apo të shfrytëzuara do të lidhen kryesisht me bazamentet për pajisjet e impiantit, hapësirat për vendosjen e thërrmuesit, sitave, shiritave transportues, bunkerëve dhe zonave ndihmëse. Sipërfaqet e pa ndërtuara do të përdoren për qarkullim, manovrim, deponim të përkohshëm të fraksioneve dhe hapësira të lira operative. Nuk priten ndikime të drejtpërdrejta në sipërfaqe të banuara, pasi objektet më të afërta të banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km nga lokacioni i projektit.

#### **6.29. Shfrytëzimi i tokës**

Shfrytëzimi i tokës në lokacionin e projektit do të ndryshojë nga gjendja ekzistuese në sipërfaqe operative për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror. Kjo përfshin përdorimin e tokës për vendosjen e pajisjeve, rrugët e brendshme, pranimin e materialit, deponimin e përkohshëm të fraksioneve dhe qarkullimin e mjeteve transportuese. Ndikimi në tokën bujqësore me vlerë të lartë prodhuese vlerësohet i kufizuar, pasi projekti nuk zhvillohet për qëllime bujqësore dhe lidhet me aktivitet industrial të përpunimit mekanik të materialit

gëlqeror. Pas përfundimit të funksionimit të impiantit, lokacioni do të rehabilitohet përmes largimit të pajisjeve, pastrimit të sipërfaqes, nivelimit të terrenit dhe rikthimit të tij në gjendje të qëndrueshme për përdorime të ardhshme.

#### **6.30. Infrastruktura komunale**

Projekti nuk pritet të shkaktojë ngarkesë të konsiderueshme në infrastrukturën komunale. Ndërlidhja kryesore me infrastrukturën ekzistuese do të jetë përdorimi i rrugëve për qasje në lokacion dhe për transportin e materialit gëlqeror e produktit final. Projekti mund të ketë nevojë për furnizim me energji elektrike për funksionimin e pajisjeve të impiantit, ndërsa uji mund të përdoret vetëm për spërkatje të sipërfaqeve operative dhe rrugëve të brendshme, me qëllim kontrollin e pluhurit. Impianti nuk parasheh lidhje të veçantë me kanalizim për proces teknologjik, pasi nuk gjenerohen ujëra industriale nga thërrmimi dhe separimi i materialit. Mbeturinat komunale nga personeli do të menaxhohen përmes sistemit komunal ose operatorit të kontraktuar.

#### **6.31. Trafiku**

Ndikimi në trafik lidhet me lëvizjen e kamionëve që do të transportojnë gurin gëlqeror nga zona e planifikuar e eksploatimit drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit, si dhe me transportimin e fraksioneve të gatshme nga impianti drejt destinacioneve të përdorimit. Rritja e qarkullimit të mjeteve të rënda mund të ndikojë në rrugët lokale, sidomos gjatë orarit të punës. Për këtë arsye, transporti duhet të organizohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar shpejtësitë e lejuara, duke mirëmbajtur rrugët e brendshme dhe duke shmangur krijimin e pengesave për banorët dhe trafikun lokal. Me organizim të rregullt të hyrje daljeve dhe me kufizim të shpejtësisë së kamionëve, ndikimi në trafik vlerësohet i menaxhueshëm.

#### **6.32. Furnizimi me ujë**

Në kuadër të projektit nuk parashihet përdorim i ujit për larje industriale apo për proces teknologjik të përpunimit të gurit gëlqeror. Procesi i impiantit përfshin vetëm thërrmim, sitje dhe separim mekanik të materialit. Uji mund të përdoret vetëm për nevojat ndihmëse, kryesisht për spërkatjen e rrugëve të brendshme, sipërfaqeve operative dhe materialit gjatë periudhave të thata, me qëllim zvogëlimin e pluhurit. Gjithashtu, ujë i pijshëm duhet të sigurohet për nevojat e personelit. Për këtë arsye, kërkesa për ujë vlerësohet e kufizuar dhe nuk pritet të krijojë ngarkesë të konsiderueshme në burimet ujore.

### **6.33. Energjia**

Projekti mund të ketë nevojë për furnizim me energji elektrike për funksionimin e pajisjeve të impiantit, si thërrmuesit, sitat vibruese, shiritat transportues dhe pajisjet ndihmëse. Furnizimi me energji do të realizohet sipas kushteve teknike dhe mundësive të kyçjes në rrjetin ekzistues. Në rast se përdoren pajisje ndihmëse, gjeneratorë, kamionë apo makineri me karburant dizel, ato duhet të jenë në gjendje të mirë teknike dhe të mirëmbahen rregullisht. Përdorimi i energjisë dhe karburantit do të lidhet vetëm me nevojat operative të impiantit dhe nuk pritet të paraqesë ndikim të rëndësishëm në mjedis, nëse zbatohen masat për mirëmbajtje dhe parandalim të rrjedhjeve aksidentale.

### **6.34. Ujërat e zeza**

Projekti nuk gjeneron ujëra të zeza teknologjike apo industriale, pasi procesi i thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nuk përfshin larje të materialit dhe nuk përdor ujë në procesin e përpunimit. Për këtë arsye, nuk parashihen shkarkime të ujërave teknologjike nga impianti. Ujërat sanitare mund të krijohen vetëm nga personeli i angazhuar në lokacion. Duke qenë se nuk parashihet ndërtimi i kampeve apo rezidencave për punëtorë, sasia e ujërave sanitare do të jetë e vogël dhe duhet të menaxhohet përmes zgjidhjeve sanitare të përshtatshme, në përputhje me kushtet e operimit dhe kërkesat ligjore.

### **6.35. Gjenerimi i mbeturinave**

Gjatë ndërtimit, montimit dhe funksionimit të impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nuk pritet të gjenerohen mbeturina industriale të rrezikshme nga vetë procesi teknologjik, pasi aktiviteti përfshin vetëm përpunim mekanik të materialit. Materiali që nuk arrin fraksionin e kërkuar mund të rikthehet përsëri në procesin e thërrmimit ose të përdoret si material mbushës. Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit mund të krijohen mbeturina nga ambalazhet e pajisjeve, pjesë metalike, plastike, karton, dru dhe mbeturina të zakonshme nga punëtorët. Gjatë operimit, mbeturinat kryesore do të jenë mbeturinat komunale nga personeli, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të zakonshme. Të gjitha mbeturinat duhet të grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe të largohen përmes sistemit komunal ose operatorëve të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave.

### **6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit**

Në zonën ku planifikohet ndërtimi dhe funksionalizimi i impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nuk janë identifikuar pasuri të mbrojtura natyrore, kulturore apo historike brenda lokacionit të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tij. Lokacioni do të shfrytëzohet për aktivitet të përpunimit mekanik të gurit gëlqeror, përkatësisht për thërrmim, sitje, separim dhe deponim të përkohshëm të fraksioneve. Ndikimi në peizazh lidhet kryesisht me vendosjen e pajisjeve të impiantit, lëvizjen e kamionëve dhe makinerive, si dhe krijimin e grumbujve të përkohshëm të materialit të thërrmuar. Ky ndikim do të jetë lokal dhe i kufizuar brenda hapësirës së projektit. Organizimi i rregullt i lokacionit, ndarja e zonave të punës dhe rehabilitimi i sipërfaqes pas përfundimit të aktivitetit do të ndihmojnë në zvogëlimin e ndikimit vizual.

### **6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga**

Ndikimet e projektit në mjedis rezultojnë kryesisht nga punët përgatitore, ndërtimi dhe vendosja e pajisjeve të impiantit, pranimi i gurit gëlqeror, thërrmimi, sitja, separimi, deponimi i përkohshëm i fraksioneve, përdorimi i makinerive dhe qarkullimi i kamionëve. Këto ndikime lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, emetimet nga mjetet me karburant, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe ndryshimin e përkohshëm të përdorimit të sipërfaqes së tokës. Ndikimet kanë karakter lokal dhe janë të menaxhueshme përmes masave teknike, organizative dhe mjedisore, si kontrolli i pluhurit, mirëmbajtja e pajisjeve, menaxhimi i rrugëve të brendshme dhe organizimi i rregullt i hapësirës operative.

### **6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit**

Zbatimi i projektit përfshin punët përgatitore në lokacion, si pastrimi i sipërfaqes, nivelimi i terrenit, përgatitja e bazamenteve për vendosjen e pajisjeve, organizimi i rrugëve të brendshme dhe përcaktimi i hapësirave për pranimin, përpunimin dhe deponimin e përkohshëm të materialit. Gjatë këtyre punimeve mund të paraqiten ndikime të përkohshme në tokë, pluhur, zhurmë dhe qarkullim të makinerive. Pas përgatitjes së lokacionit, do të bëhet sjellja dhe montimi i pajisjeve të impiantit, si thërrmuesit, sitat vibruese, shiritat transportues, bunkerët dhe pajisjet ndihmëse. Në rast të përfundimit të funksionimit të projektit, pajisjet do të largohen nga lokacioni, materiali i mbetur do të pastrohet dhe sipërfaqja do të rehabilitohet në gjendje të sigurt dhe të përshtatshme për përdorime të ardhshme.

#### **6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese**

Ndikimet kumulative mund të lidhen me projektin e planifikuar të eksploatimit të gurit gëlqeror nga e njëjta kompani, pasi materiali i nxjerrë nga zona e eksploatimit do të transportohet drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit për përpunim mekanik. Këto dy aktivitete janë të ndërlidhura funksionalisht dhe mund të krijojnë ndikime të përbashkëta në formë të pluhurit, zhurmës, qarkullimit të kamionëve dhe ndryshimeve vizuale në zonë. Ndikimet kumulative mund të menaxhohen përmes organizimit të mirë të transportit, mirëmbajtjes së rrugëve të brendshme, kontrollit të pluhurit, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe respektimit të orarit të punës. Duke qenë se shtëpitë e banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km, ndikimi kumulativ në popullsinë lokale vlerësohet i kufizuar dhe i menaxhueshëm.

#### **6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis**

Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative pritet të jetë kryesisht lokale dhe e kufizuar brenda lokacionit të impiantit, rrugëve të brendshme dhe hapësirave ku bëhet pranimi, thërrmimi, seperimi dhe deponimi i përkohshëm i materialit. Duke qenë se shtëpitë e banimit ndodhen më shumë se 1 km larg lokacionit të projektit, ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë lokale vlerësohet i kufizuar. Ndikimet në tokë, peizazh dhe përdorimin e hapësirës do të jenë të kufizuara brenda lokacionit të paraparë për impiantin.

#### **6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit**

Gjatë fazës së ndërtimit dhe montimit të impiantit nuk pritet gjenerim apo shkarkim i ujërave të ndotura teknologjike, pasi punimet përfshijnë kryesisht përgatitjen e lokacionit, vendosjen e pajisjeve dhe organizimin e hapësirës operative. Nuk parashihet larje industriale e materialit dhe nuk do të ketë shkarkime të ujërave teknologjike në tokë, përroska apo rrjedha ujore.

#### **6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit**

Gjatë ndërtimit dhe montimit të impiantit nuk priten emetime të rrezatimit elektromagnetik, pasi nuk do të instalohen pajisje apo sisteme që krijojnë rrezatim të tillë në nivele të rëndësishme për mjedisin apo shëndetin e njeriut. Aktiviteti përfshin përdorimin e makinerive për përgatitjen e lokacionit dhe montimin e pajisjeve mekanike të impiantit. Për këtë arsye, ndikimi nga rrezatimi elektromagnetik gjatë fazës së ndërtimit vlerësohet si i papërfillshëm.

#### **6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit**

Gjatë operimit të impiantit do të ketë emetime të kufizuara të gazeve serrë nga përdorimi i karburantit dizel në kamionë, ngarkues dhe makineri ndihmëse. Këto emetime lidhen me djegien e karburantit dhe kanë karakter lokal. Nëse pajisjet kryesore të impiantit funksionojnë

me energji elektrike, emetimet direkte nga procesi i thërrmimit dhe separimit do të jenë më të kufizuara. Projekti nuk përfshin procese industriale me djegie të vazhdueshme, trajtim termik apo procese kimike që gjenerojnë sasi të mëdha të gazeve serrë. Për zvogëlimin e emetimeve do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e makinerive, përdorimi racional i karburantit, shmangia e punës së panevojshme të motorëve në gjendje të ndezur dhe organizimi efikas i transportit.

#### **6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike**

Ndikimi i projektit në ndryshimet klimatike vlerësohet i kufizuar, pasi aktiviteti përfshin përpunim mekanik të gurit gëlqeror dhe nuk përfshin prodhim industrial me emetime të larta. Emetimet kryesore lidhen me përdorimin e karburantit nga kamionët, ngarkuesit dhe makineritë ndihmëse. Nga ana tjetër, projekti mund të jetë i ndjeshëm ndaj kushteve klimatike, si periudhat e thata që mund të rrisin pluhurin, temperaturat e larta që ndikojnë në kushtet e punës, si dhe reshjet intensive që mund të ndikojnë në qarkullimin brenda lokacionit dhe në menaxhimin e ujërave atmosferike. Për këtë arsye duhet të zbatohen masa për spërkatjen e sipërfaqeve gjatë periudhave të thata, mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme.

## **7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS**

### **7.1.Masat e parashikuara me legjislacion**

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, janë paraparë masa për parandalimin, reduktimin dhe menaxhimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis. Projekti përfshin pranimin e gurit gëlqeror, thërrmimin, sitjen, seperimin, klasifikimin dhe deponimin e përkohshëm të fraksioneve të gatshme. Ndikimet kryesore lidhen me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e kamionëve, përdorimin e makinerive dhe mbeturinat që mund të krijohen gjatë ndërtimit, montimit dhe operimit.

### **7.2.Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha**

Në rast të aksidenteve apo fatkeqësive të mëdha gjatë funksionimit të impiantit, operatori duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për mbrojtjen e punëtorëve, mjedisit dhe pronës. Aktiviteti duhet të ndërpritet menjëherë në zonën ku ka ndodhur incidenti dhe personat e rrezikuar duhet të largohen në vend të sigurt.

Në rast të derdhjes aksidentale të vajrave, karburanteve apo substancave të tjera ndotëse, zona duhet të izolohet dhe materiali i derdhur të mblidhet me absorbues. Toka e kontaminuar duhet të largohet dhe të trajtohet sipas rregullave për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

Në rast zjarri, duhet të përdoren menjëherë aparatet për shuarje të zjarrit dhe të njoftohen shërbimet emergjente. Makineritë dhe pajisjet duhet të mirëmbahen rregullisht për të ulur rrezikun nga defektet teknike, mbinxehja apo rrjedhjet e karburantit.

Në rast të reshjeve të mëdha, rrëshqitjeve apo erozionit, duhet të ndërpritet puna në zonat e rrezikuara dhe të kontrollohet stabiliteti i terrenit, grumbujve të materialit dhe rrugëve të brendshme. Materiali i depozituar duhet të vendoset në mënyrë të sigurt, që të mos shpërndahet apo të bartet nga ujërat sipërfaqësore.

Operatori duhet të ketë plan të reagimit emergjent, pajisje të nevojshme për ndërhyrje, kuti të ndihmës së parë, aparate kundër zjarrit dhe mjete për absorbimin e derdhjeve. Të gjithë punëtorët duhet të jenë të njoftuar me procedurat e sigurisë dhe me mënyrën e veprimit në rast aksidenti.



### **7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit**

Për mbrojtjen e mjedisit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të thërrmimit dhe sepaeimit të gurit gëlqeror parashihen këto zgjidhje teknike dhe organizative:

- Punimet dhe aktivitetet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lokacionit të miratuar për projektin;
- Pajisjet e impiantit të vendosen në mënyrë të organizuar, duke respektuar planin teknik të lokacionit;
- Rrugët e brendshme dhe sipërfaqet operative të mirëmbahen rregullisht dhe të lagen gjatë periudhave të thata për zvogëlimin e pluhurit;
- Pikat ku krijohet më shumë pluhur, si thërrmuesi, sitat, shiritat transportues dhe zonat e deponimit, të kontrollohen me masa për uljen e pluhurit;
- Kamionët dhe makineritë të qarkullojnë me shpejtësi të kufizuar brenda lokacionit;
- Materiali i deponuar përkohësisht të vendoset në grumbuj të rregullt dhe të ndarë sipas fraksioneve;
- Makineritë, kamionët dhe pajisjet e impiantit të mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar emetimet e gazrave, zhurmën dhe rrezikun nga rrjedhjet e vajrave apo karburantit;
- Të mos lejohet shkarkimi i pakontrolluar i ujërave, vajrave, karburanteve apo mbeturinave në tokë;
- Ujërat atmosferike të menaxhohen në mënyrë që të mos bartin material të imët jashtë lokacionit;
- Mbeturinat komunale nga personeli të grumbullohen në kontejnerë dhe të largohen nga operatori i kontraktuar;
- Pas përfundimit të funksionimit të impiantit, pajisjet të largohen, lokacioni të pastrohet dhe sipërfaqja të rehabilitohet.

### **7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis**

Përveç masave teknike dhe ligjore, gjatë ndërtimit dhe funksionimit të projektit duhet të zbatohen edhe masa shtesë për mbrojtjen e mjedisit:

- Të kufizohet lëvizja e makinerive vetëm në rrugët dhe hapësirat e përcaktuara brenda lokacionit;
- Të shmanget dëmtimi i panevojshëm i vegjetacionit përreth zonës së projektit;
- Të respektohet orari i punës për të kufizuar ndikimet nga zhurma;

- Të përdoren pajisje mbrojtëse personale nga punëtorët, sidomos gjatë operimit pranë thërmuesit, sitave, shiritave transportues dhe zonave të ngarkimit;
- Të vendosen shenja paralajmëruese dhe informuese në zonën e punës;
- Të bëhet kontroll i rregullt i gjendjes teknike të pajisjeve dhe makinerive;
- Të bëhet monitorim periodik i ndikimeve kryesore, sidomos pluhurit, zhurmës, mbeturinave dhe gjendjes së tokës;
- Të mbahet lokacioni i pastër dhe i organizuar gjatë gjithë periudhës së funksionimit;
- Të mos lejohet grumbullimi i pakontrolluar i materialit jashtë zonave të përcaktuara;
- Të bëhet pastrimi i rregullt i rrugëve të brendshme dhe hapësirave operative;
- Të ndërpritet puna përkohësisht në kushte të pafavorshme atmosferike, nëse krijohet përhapje e madhe e pluhurit apo rrezik për sigurinë e punëtorëve.

Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimet e projektit në ajër, tokë, ujë, biodiversitet, peizazh dhe popullsi të jenë të kufizuara, të kontrolluara dhe të menaxhueshme gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit të impiantit.

## **8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

### **8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis**

Programi i monitorimit për projektin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ka për qëllim përcjelljen e ndikimeve të mundshme në mjedis gjatë fazës së ndërtimit, montimit dhe funksionimit të impiantit. Monitorimi do të fokusohet kryesisht në pluhur, zhurmë, gjendjen e tokës, menaxhimin e mbeturinave, funksionimin e pajisjeve dhe ndikimet e mundshme nga qarkullimi i kamionëve dhe makinerive.

### **8.2. Gjendja mjedisore para fillimit të projektit**

Para fillimit të ndërtimit dhe funksionimit të impiantit duhet të evidentohen kushtet ekzistuese të lokacionit, duke përfshirë gjendjen e tokës, mbulesën bimore, qasjen rrugore, afërsinë me vendbanimet, burimet ujore dhe gjendjen e përgjithshme mjedisore të zonës. Lokacioni i projektit ndodhet jashtë zonës së banimit. Shtëpitë e banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km, ndërsa ndikimet e mundshme pritet të jenë të kufizuara brenda hapësirës operative të impiantit dhe rrugëve të qarkullimit.

### **8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis**

Për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror, parametrat kryesorë që do të monitorohen për të përcaktuar efektet e mundshme të dëmshme në mjedis lidhen me cilësinë e ajrit, nivelet e zhurmës, gjendjen e tokës, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe menaxhimin e mbeturinave. Do të vlerësohet niveli i pluhurit gjatë shkarkimit të materialit, thërrmimit, sitjes, separimit, bartjes me shirita transportues, deponimit të fraksioneve dhe qarkullimit të kamionëve. Po ashtu do të monitorohen emetimet nga makineritë dhe mjetet transportuese që përdorin karburant dizel. Gjendja e tokës do të kontrollohet për çdo rrjedhje të mundshme të karburantit apo vajrave, ndërsa do të mbikëqyret edhe menaxhimi i mbeturinave komunale dhe mbeturinave eventuale nga mirëmbajtja e pajisjeve. Monitorimi i këtyre parametrave mundëson identifikimin në kohë të çdo devijimi nga kushtet e lejuara dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese, në mënyrë që ndikimet mjedisore të mbeten të kontrolluara dhe brenda standardeve ligjore.

### **8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar**

Matjet dhe kontrollimet do të realizohen brenda lokacionit të impiantit, kryesisht në zonën e thërrmuesit, sitave, shiritave transportues, hapësirave të deponimit të fraksioneve, rrugëve të brendshme dhe pikave të shkarkimit e ngarkimit të materialit. Sipas nevojës, kontrollime mund të kryhen edhe në kufijtë e lokacionit për të vlerësuar përhapjen e pluhurit dhe zhurmës jashtë

zonës operative. Gjatë periudhave me aktivitet më intensiv, monitorimi duhet të jetë më i rregullt, sidomos për pluhurin dhe zhurmën. Në operim normal, kontrollet do të kryhen në mënyrë periodike përmes inspektimeve të brendshme dhe vlerësimeve teknike. Matjet e zhurmës dhe pluhurit, kur kërkohen nga autoritetet kompetente ose sipas kushteve të pëlqimit mjedisor, do të realizohen me pajisje të përshtatshme dhe nga persona apo institucione të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **8.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera**

Raportet e monitorimit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror do të përfshijnë rezultatet e matjeve dhe kontrolleve të kryera për pluhurin, nivelet e zhurmës, gjendjen e tokës, menaxhimin e mbeturinave dhe kontrollin e mundshëm të rrjedhjeve të karburantit apo vajrave. Në raport do të përfshihet analiza e të dhënave, krahasimi me vlerat kufitare të lejuara sipas legjislacionit në fuqi dhe vlerësimi i zbatimit të masave mjedisore. Në rast se evidentohen devijime nga standardet e lejuara, raporti duhet të përmbajë edhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes. Dorëzimi i raporteve do të bëhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të autoriteteve kompetente dhe kushteve të përcaktuara në pëlqimin mjedisor apo lejet përkatëse.

#### **8.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera**

Kompania është e obliguar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun lidhur me rezultatet e monitorimit mjedisor për impiantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e pëlqimit mjedisor. Informimi realizohet përmes raporteve zyrtare që i dorëzohen autoriteteve kompetente, ndërsa në rast se kërkohet, rezultatet mund të bëhen publike përmes njoftimeve apo formave të tjera të komunikimit të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse. Kjo siguron që aktiviteti të zhvillohet me përgjegjësi dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### **8.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis**

Bazuar në natyrën e aktivitetit, i cili përfshin pranimin e gurit gëlqeror, thërrmimin, sitjen, seperimin, klasifikimin dhe deponimin e përkohshëm të fraksioneve, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta dhe të matshme që mund të shtrihen përtej kufirit shtetëror. Ndikimet e projektit kanë karakter lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, qarkullimin e kamionëve dhe menaxhimin e ujërave atmosferike brenda lokacionit. Duke qenë se projekti nuk parasheh shkarkime në ujëra ndërkufitare, nuk ka emetime industriale me përhapje të gjerë dhe nuk përdor substanca të rrezikshme që mund të ndikojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, rreziku për ndikim ndërkufitar vlerësohet shumë i ulët.

## **9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR**

### **9.1.Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit**

Plani i Menaxhimit Mjedisor synon të sigurojë mbrojtje efektive të mjedisit gjatë të gjitha fazave të projektit për ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, duke përfshirë fazën përgatitore, fazën e ndërtimit dhe montimit, fazën e operimit dhe fazën e mbylljes së aktivitetit. Gjatë fazës përgatitore dhe të ndërtimit do të zbatohet organizim i kontrolluar i punimeve në lokacion, me kufizim të ndërhyrjeve vetëm brenda hapësirës së parapare për vendosjen e impiantit. Kujdes i veçantë do t’i kushtohet përgatitjes së terrenit, vendosjes së pajisjeve, organizimit të rrugëve të brendshme, kontrollit të pluhurit, zhurmës dhe parandalimit të ndotjes së tokës nga rrjedhjet aksidentale të karburantit apo vajrave. Gjatë fazës së operimit, fokusi do të jetë në funksionimin e kontrolluar të impiantit, përfshirë pranimin e gurit gëlqeror, thërrmimin, sitjen, separimin, deponimin e përkohshëm të fraksioneve dhe transportimin e produktit final. Do të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, mirëmbajtjen e pajisjeve, kufizimin e zhurmës, menaxhimin e mbeturinave dhe organizimin e sigurt të qarkullimit të kamionëve dhe makinerive. Aktiviteti do të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kushtet e pëlqimit mjedisor, lejet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të funksionimit të impiantit, do të zbatohet mbyllja e kontrolluar e aktivitetit, largimi i pajisjeve, pastrimi i lokacionit dhe rehabilitimi i sipërfaqes së përdorur, me qëllim që zona të lihet në gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

### **9.2.Pajtushmeria me pëlqim mjedisor**

Zbatimi dhe operimi i projektit për impiantin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K. do të realizohet në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në pëlqimin mjedisor, lejet përkatëse dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Kompania është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha masave mbrojtëse të përcaktuara në raport, për monitorimin e rregullt të ndikimeve në ajër, zhurmë, tokë dhe për menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu, kompania do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen teknike të pajisjeve të impiantit, makinerive dhe mjeteve transportuese, si dhe për parandalimin e çdo ndotjeje të mundshme nga karburantet, vajrat apo materialet tjera ndihmëse. Kompania do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, organet inspektuese dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit. Çdo ndryshim eventual në kapacitetin e përpunimit, mënyrën e operimit, shtrirjen e lokacionit, teknologjinë e përdorur apo parametrat teknikë të projektit do të trajtohet

në përputhje me procedurat ligjore dhe do të njoftohen autoritetet kompetente para zbatimit të tyre.

### **9.3. Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000**

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedisor, në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore nga impianti;
- përmirësimin e efikasitetit operativ gjatë thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror;
- kontrollin më të mirë të pluhurit, zhurmës, mbeturinave;
- rritjen e përgjegjësisë mjedisore të personelit;
- përmbushjen më të lartë të kërkesave ligjore dhe institucionale;
- përmirësimin e dokumentimit, monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të realizohet në mënyrë graduale, duke u përshtatur me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të impiantit. Ky sistem do të ndihmojë që projekti të operojë në mënyrë më të kontrolluar, më të sigurt dhe më të qëndrueshme për mjedisin.

## **10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT**

### **10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,**

Projekti për impiantin e thërrimit dhe separimit të gurit gëlqeror është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L 181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe aktet nënligjore përkatëse, me qëllim vlerësimin e ndikimeve të mundshme që mund të paraqiten gjatë funksionimit të aktivitetit.

Karakteristikat kryesore që kanë ndikuar në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së këtij raporti janë natyra mekanike e procesit, kapaciteti i ulët i impiantit, mënyra e pranimi dhe përpunimit të gurit gëlqeror, si dhe organizimi i sipërfaqes së punës për thërrim, sitje, separim dhe depozitim të fraksioneve të gatshme.

Procesi i punës përfshin pranimin e materialit guror, furnizimin e impiantit, thërrimin mekanik, ndarjen granulometrike përmes sitjes dhe separimit, si dhe depozitimin e materialit të përpunuar brenda lokacionit. Projekti nuk përfshin përdorim të substancave kimike, nuk ka djegie industriale dhe nuk gjeneron ujëra teknologjike. Uji do të përdoret vetëm për spërkatje të sipërfaqeve të punës dhe rrugëve të brendshme, me qëllim zvogëlimin e pluhurit.

Ndikimet kryesore mjedisore janë të karakterit lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, vibrimet nga puna e pajisjeve mekanike, qarkullimin e mjeteve transportuese, depozitimin e materialit dhe ndryshimet vizuale në lokacion. Këto ndikime konsiderohen të menaxhueshme përmes masave të rregullta mbrojtëse, mirëmbajtjes së pajisjeve, spërkatjes me ujë, organizimit të qarkullimit të brendshëm dhe menaxhimit të kontrolluar të materialit.

Informacionet e përfshira në këtë raport kanë për qëllim të sigurojnë qartësi për natyrën e projektit, përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe bazë të mjaftueshme për përcaktimin e masave mbrojtëse. Qëllimi kryesor është që funksionimi i impiantit të thërrimit dhe separimit të gurit gëlqeror të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

### **10.2. Baza ligjore dhe rregullative**

Hartimi i këtij Raporti të VNM-së është mbështetur në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, e cila është e harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për industrinë nxjerrëse dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### **Ligjet dhe Udhëzimet Administrative**

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis: Ligji bazë që rregullon procedurat

- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit: Përcakton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158): Rregullon shfrytëzimin e resurseve minerale.
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës: Për mbrojtjen e pellgjeve ujore.
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja: Për limitet e pluhurit dhe gazeve.
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina: Për menaxhimin e mbeturinave (Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina).
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma: Për limitet akustike në zona të banuara.
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës: Për ruajtjen e biodiversitetit

Udhëzimet Administrative (UA):

- UA Nr. 07/2021: Për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër.
- UA Nr. 02/2022: Për normat e shkarkimit të ujërave të ndotura.
- UA Nr. 08/2009: Për vlerat kufitare të zhurmës.
- UA Nr. 04/2025: Për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit

### **10.3. Dokumentacioni teknik i projektit**

Dokumentacioni teknik i projektit për impiantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror përfshin të dhënat kryesore për lokacionin, sipërfaqen e shfrytëzimit, vendosjen e pajisjeve, kapacitetin e planifikuar dhe mënyrën e funksionimit të impiantit.

Në këtë dokumentacion përfshihen planimetria e lokacionit, ndarja e zonave të punës, rrugët e brendshme të qarkullimit, hapësirat për pranimin e materialit, thërrmimin, sitjen, separimin dhe depozitimin e fraksioneve të gatshme. Kjo sipërfaqe përfshin 3.46 hektar.

Gjithashtu, dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna për pajisjet që do të përdoren, furnizimin me ujë për spërkatje, masat për kontrollin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e tokës dhe ujërave.

Si dokumente përcjellëse mund të përfshihen dokumentet e biznesit, dëshmia për të drejtën e shfrytëzimit të lokacionit, kopja e planit kadastral, ortofotoja, skica apo planimetria e vendosjes së impiantit dhe përshkrimi teknik i pajisjeve.



## **11. BURIMET E TË DHËNAVE**

### **11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së**

*Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.*

- TE DHËNAT NGA INVESTITORI
- [suhareke.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/11/PZHK\\_Suhareka\\_-2021-2029-Pjesa-Tekstuale.pdf](http://suhareke.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/11/PZHK_Suhareka_-2021-2029-Pjesa-Tekstuale.pdf)
- [Kosovo Geoportal](#)
- [Suhareke, 23000 to 42.4084343, 20.8303738 - Google Maps](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV \(MMPHI\) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE, PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHITETËROR TË MBETURINAVE](#)

## **12. SHTOJCA**

1. Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
2. Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
3. Vlera investive e projektit në formë tabelare.
4. Certifikata e regjistrimit të biznesit.
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
6. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
7. Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
8. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, në rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit.
9. Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
10. Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

### **13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT**

#### **13.1. Hyrje**

Projekti i propozuar ka të bëjë me ndërtimin dhe funksionalizimin e impiantit të thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Impianti do jete i shtrire ne këto parcela kadastrale: P-72116003-04427-0, P-72116003-04428-0, P-72116003-04429-0, dhe P-72116003-04430-0. Aktualisht impianti nuk është i ndërtuar dhe nuk është në funksion, por planifikohet të realizohet si projekt i ri për përpunimin mekanik të gurit gëlqeror dhe prodhimin e fraksioneve granulometrike për nevoja të ndërtimtarisë, infrastrukturës rrugore, betonit, asfaltit dhe tregut të materialeve ndërtimore.

#### **13.2. Përshkrimi i projektit**

Lënda e parë për këtë impiant do të jetë guri gëlqeror, i cili do të pranohet në lokacion si material hyrës për përpunim mekanik. Pas pranimi, materiali do të shkarkohet në hapësirën e caktuar për pranimin e lëndës së parë ose në bunkerët hyrës të impiantit, prej nga do të kalojë në procesin e thërrmimit, sitjes, separimit dhe klasifikimit sipas fraksioneve të kërkuara.

Procesi teknologjik do të jetë mekanik dhe nuk përfshin trajtim kimik, djegie industriale apo larje të materialit. Materiali i pranuar do të kalojë fillimisht në thërrmues, ku do të zvogëlohet në përmasa më të vogla. Pas thërrmimit, materiali do të bartet me shirita transportues drejt sitave, ku do të ndahet sipas madhësisë së kokrrizave. Fraksionet e gatshme do të deponohen përkohësisht në hapësira të veçanta brenda lokacionit dhe më pas do të ngarkohen për transport drejt tregut apo destinacioneve të përdorimit.

Lokacioni ndodhet jashtë zonës së drejtpërdrejtë të banimit. Shtëpitë më të afërta ndodhen në distancë më të madhe se 1 km nga projekti, prandaj ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë lokale vlerësohet i kufizuar. Brenda zonës së projektit nuk janë evidentuar pasuri të mbrojtura natyrore, kulturore apo historike.

#### **13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse**

Ndikimet kryesore mjedisore janë të karakterit lokal dhe lidhen kryesisht me krijimin e pluhurit gjatë shkarkimit, thërrmimit, sitjes, separimit, deponimit të fraksioneve dhe lëvizjes së kamionëve në rrugët e brendshme. Ndikime të tjera mund të paraqiten nga zhurma e pajisjeve të impiantit, si thërrmuesit, sitat vibruese, shiritat transportues, ngarkuesit dhe mjetet transportuese.

Emetime të kufizuara në ajër mund të krijohen nga makineritë dhe kamionët që përdorin karburant dizel. Projekti nuk parasheh përdorim të ujit për larje industriale të gurit gëlqeror dhe nuk gjeneron ujëra teknologjike. Uji do të përdoret vetëm për spërkatjen e rrugëve të

brendshme, sipërfaqeve operative dhe materialit gjatë periudhave të thata, me qëllim zvogëlimin e pluhurit.

Ndikimet në ujë vlerësohen të ulëta dhe të menaxhueshme. Rreziku kryesor lidhet vetëm me rrjedhje të mundshme aksidentale të karburanteve apo vajrave nga makineritë, të cilat duhet të parandalohen përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe masave të kontrollit.

Masat kryesore mbrojtëse përfshijnë kontrollin e pluhurit përmes spërkatjes me ujë, mirëmbajtjen e pajisjeve, kufizimin e shpejtësisë së kamionëve, organizimin e qarkullimit të brendshëm, menaxhimin e ujërave atmosferike, grumbullimin e mbeturinave komunale dhe trajtimin e kontrolluar të mbeturinave eventuale nga mirëmbajtja e pajisjeve. Pas përfundimit të funksionimit, parashihet largimi i pajisjeve, pastrimi i lokacionit, nivelimi i terrenit dhe rehabilitimi i sipërfaqes së përdorur.

#### **13.4. Përfitimet socio-ekonomike**

Projekti pritet të sjellë përfitime ekonomike, pasi mundëson përpunimin e gurit gëlqeror dhe prodhimin e fraksioneve të gatshme për treg. Impianti do të krijojë vlerë të shtuar për materialin e nxjerrë nga zona e eksploatimit, duke e kthyer atë nga material i papërpunuar në produkt të gatshëm për përdorim teknik.

Përfitimet kryesore lidhen me angazhimin e fuqisë punëtore, furnizimin e tregut lokal me materiale ndërtimore, mbështetjen e sektorit të ndërtimit, infrastrukturës rrugore, betonit dhe asfaltit. Po ashtu, vendosja e implantit në afërsi të zonës së planifikuar të eksploatimit mundëson organizim më efikas të transportit dhe përpunimit të materialit.

#### **13.5. Përfundim**

Projekti për implantin e thërrmimit dhe separimit të gurit gëlqeror nga “StoneX Holding” SH.P.K. paraqet një aktivitet të planifikuar të përpunimit mekanik të materialit mineral. Ndikimet e tij në mjedis janë të menaxhueshme dhe pritet të jenë të kufizuara kryesisht brenda lokacionit të projektit.

Duke marrë parasysh natyrën mekanike të procesit, mungesën e trajtimit kimik, mungesën e ujërave teknologjike dhe distancën nga zonat e banimit, projekti mund të konsiderohet i pranueshëm nga aspekti mjedisor, me kusht që të zbatohen masat mbrojtëse, monitoruese dhe rehabilituese të parapara në raport.